

Kumbona e së Diellës



Kujtim nga Shkodra Zoja e Shkodrës

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.9/10, Shtator - Tetor 2021

“NUK JENI VETËM”: PAPA LUTET PËR DETARËT E MËRGUAR NGA PANDEMIA, Vatikan, 30 shtator 2021

Me rastin e Ditës Botërore të Detarisë, Papa Françesku kujton sakrificat e peshkatarëve dhe punëtorëve në këtë sektor, veçanërisht ato mijëra që Covid-i po i mban larg familjeve që prej një viti e gjysmë: puna juaj në det shpesh ju mban larg, por ju jeni të pranishëm në lutjet e mia dhe në mendimet e mia.

“Le të lutemi së bashku për detarët dhe peshkatarët, të cilët në kohët e fundit janë përballur me kaq shumë sakrifica duke siguruar, me punën e tyre, ushqimin dhe nevojat e tjera themelore për familjen e madhe njerëzore për të lehtësuar vuajtjet e shkaktuara nga pandemia”. Papa Françesku në Twitter kujton Ditën Botërore të Detarisë, të shpallur nga OKB –ja, e cila kujtohet këtë ditë.

Një sakrificë për të gjithë

Me këtë rast, Kombet e Bashkuara nxjerrin në pah problemin serioz të mijëra detarëve të cilët, veçanërisht në kohën e urgjencës shëndetësore, kanë ngelur të bllokuar në det, larg njerëzve të dashur me frikën e infektimit. Personat në fjalë janë rreth 400,000, larg shtëpive të tyre që prej 18 muajsh, që nga shtatori 2020. Tema është trajtuar disa herë nga Kisha dhe në veçanti nga Papa. Në një video mesazh, në qershor të vitit 2020, Françesku pati shprehur vëmendjen dhe afërsinë e tij ndaj sakrificave të hasura, duke garantuar transportin e 90% të mallrave dhe pajisjeve mjekësore nga një pjesë e botës në tjetrën.

Dijeni se nuk jeni vetëm dhe nuk jeni të harruar. Puna juaj në det shpesh ju mban larg, por ju jeni të pranishëm në lutjet dhe

mendimet e mia, si dhe në ato të kapelanëve dhe vullnetarëve të 'Stella Maris'. Vetë Ungjilli na e kujton këtë kur na flet për Jezusin me dishepujt e tij të parë, të cilët ishin të gjithë peshkatarë, si ju. Sot dëshiroj t'ju dërgoj një mesazh dhe një lutje shprese, një lutje mbështetjeje dhe ngushëllimi kundër të gjitha rreziqeve dhe në të njëjtën kohë inkurajoj të gjithë ata që punojnë me ju në kujdesin baritor të detarëve.

Njohja e të drejtave të detarëve

Në korrikun e kaluar, Dikasteri për Shërbimin e Zhvillimit Integral Njerëzor, në një mesazh shprehu falënderimet e veta për më shumë se 1.7 milion detarë në botë, për atë që kanë bërë gjatë pandemisë. Teksti nuk fsheh “kontradiktën e thellë” që ka zënë vend në botën e industrisë detare, “shumë të globalizuar”, por e shënuar nga paplotësia e rregullave mbi të drejtat dhe mbrojtjen e punëtorëve. Këndeje edhe kërkesa e Dikasterit për të njohur “punëtorët thelbësorë”, duke favorizuar “ndryshimet e ekuipazhit” dhe duke i dhënë përparësi një politike të qartë në lidhje me vaksinimet.





Imzot Angelo Massafra OFM DITA E KRIJIMIT	4
Redaksia HISTORIA EVROPIANE NJË NDËRTHURJE	6
Don Nosh Gjollaj KULTIVIMI I DURIMIT DHE I NJOHJES	8
Motër Marjeta Gjoka TË NJOHIM TË VËRTETËN	12
Giovanni Cucci S. I E VËRTETA, NJË VIRTYT I LËNË NË HARRESË	15
R.SH. - Vatikan 70 VITE - RADIO VATIKANI SHQIP	20
Atë Luigji Cannato, CM DIAKONI: IKONA E KRISHTIT SHËRBËTOR	23
Motrat Salvatoriane KUSHTET E PËRJETSHME	24
Fra Lorenc Pepniku FESTA E VARRËVE TË SHËN FRANÇESKUT	25
Dom Nikë Ukgjini KOLEC ÇEFA: NJË PENDË SHQIPTARE	26
Fation Mullarhi SFIDAT DHE PROBLEMATIKAT E TË RINJVE	28
Elvis Hila VARRET PO SHKATËRROJNË MONUMENTËT E KULTURËS NË LEZHË	29
Dom Nikë Ukgjini "ZOJA E SHKODRËS"	31
Redaksia VITRINA E LIBRIT	32

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXIV, nr. 9/10 (547 - 548) Shtator - Tetor 2021

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Vlash Palaj
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon Nika

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Kryedioqeza Shkodër-Pult

Prot. nr. 66/2021

Shkodër, më 24/08/2021

DITA E KRIJIMIT

Shumë të dashur Vëllezër Ipeshkvij,
Meshtarë, Rregulltarë/e dhe besimtarë të gjithë!



Në dokumentin me një rëndësi të veçantë *Charta Oecumenica*, hartuar dhe nxitur 20 vjet më parë nga Konferenca Ipeshkvnore Evropiane së bashku me Konferencën e Kishave Evropiane, është caktuar edhe një ditë ekumenike, data 1 shtator, si një ditë kushtuar Krijimit.

Ky Dokument ende duhet të njihet dhe të studiohet nga Kisha jonë në Shqipëri, por ndërkohë prej disa vitesh kemi filluar t'i bashkëngjitemi nismës, pasi tani ka ardhur koha që të fillojmë ta ndërgjegjësojmë Vendin tonë për këtë argument kaq delikat dhe urgjent, sidomos në dritën e asaj që ndodhi muajin e fundit me zjarret, të cilat kanë shkatërruar shumë zona të botës dhe të Shqipërisë sonë. Ndryshimet klimatike vazhdojnë të përparojnë me dëme që janë gjithnjë e më të mëdha. Nuk ka më kohë për të humbur.


Prandaj, u kujtoj të gjithëve nevojën që data 1 shtator 2021 t'i kushtohet reflektimit, ndërgjegjësimit dhe lutjes për këtë temë, duke caktuar edhe data të tjera ku në çdo bashkësi të

zhvillohen nisma të përshtatshme dhe domethënëse.

Reflektimi i Kishës Evropiane në këtë drejtim po përparon ndjeshëm dhe nismat që po zhvillohen në Kishat lokale janë dëshmi e këtij përparimi, siç mund të shihet edhe në faqet përkatëse të internetit. Për këtë arsye bashkëndajmë me Kishat e tjera temën që këtë vit është marrë nga Letra e Shën Palit drejtuar Romakëve “*Të jetojmë në jetën e re*” (Rom 6, 4).

Jeta e re për të cilën flitet e vendos nxënësin e Jezusit në një bashkim të thellë me Hyjin. Duke u nisur nga kjo përvojë mund të imagjinojmë një vëllazëri të vërtetë midis njerëzve, siç sugjerohet nga enciklika “Vëllezër të gjithë” dhe një marrëdhënie të re me krijimin, sipas projektit të Enciklikës “Ti qofsh lëvduar”.

Prandaj ftesa për një tranzicion/kalim që shndërron thellësisht formën tonë të jetës, për të arritur kthimin e nevojshëm ekologjik në shumë nivele, të gjallëruar nga dashuria për tokën dhe për krijesat që banojnë në të. Me këtë tranzicion/kalim i



japim shprehje kujdesit për shtëpinë e përbashkët dhe kështu i përgjigjemi përngjasimit me Hyjin që, si një Atë, kujdeset për secilën prej tyre.

Dhe po e shpjegojmë se çfarë nënkuptohet me termin “tranzicion/kalim” në fushën ekologjike. Në tranzicionin/kalimin ekologjik duhet të braktiset një model zhvillimi konsumator, që rrit padrejtësitë dhe pabarazitë, për të adoptuar një model të qendëruar në vëllazërimin midis popujve. Britma e tokës dhe britma e të varfërve na kërkojnë llogari (krh. Ti qofsh lëvdur nr. 49). Angazhohemi të shoqërojmë dhe të inkurajojmë ndryshimet e nevojshme, duke filluar nga vështrimi ynë sotitës mbi krijimin deri tek zgjedhjet tona të përditshme.

Ka shumë plane në të cilat mund të veprohet njëkohësisht:

- Nga njëra anë, është e nevojshme që të thellohet edukimi në përgjegjësi, për një humanizëm të ri që përfshin edhe kujdesin për shtëpinë e përbashkët, duke përfshirë shumë subjekte përfshira në sfidën edukative.

- Duhet të rimendohet thellësisht antropologjia, duke kapërcyer forma antro-po-centrizmi përjashtues dhe vetëreferues, për të rizbuluar atë

ndjenjë ndërlidhjeje që gjen shprehje në ekologjinë integrale, ku ekologjia njerëzore është e bashkuar me ekologjinë mjedisore.

- Në të njëjtën kohë, është e nevojshme të nxitet një shoqëri elastike dhe e qëndrueshme ku krijimi i vlerës ekonomike dhe krijimi i vendeve të punës të arrihen përmes politikave dhe strategjive që janë të vëmendshme ndaj ekspozimit ndaj rreziqeve mjedisore dhe shëndetësore.

Ndryshimi aktivizohet vetëm me shpresë dhe së bashku:

- Me një pakt midis brezave.
- Duke parë të mirën e përbashkët, e cila përfshin edhe kujdesin për shtëpinë e përbashkët.

U forcoftë angazhimi ynë edukativ për ta bërë Letrën enciklike “Ti qofsh lëvdur”, në gjashtëvjetorin e shpalljes së saj, busullën e një shërbimi bërë shoqërisë dhe Vendit tonë.

† **Angelo Massafra O.F.M.**

Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult
President i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë
Anëtar i Komisionit Social CCEE

HISTORIA EVROPIANE ËSHTË NJË NDËRTHURJE HARMONIKE

Asambleja plenare e Këshillit të Konferencave Ipeshkvnore Evropiane

Romë, 23-26 shtator 2021

Presidentët e Konferencave Ipeshkvnore Evropiane u takuan në Asamblenë Plenare, në Romë, për të kremtuar 50-vjetorin e themelimit të saj; u takuan me Papa Françeskun në Shën Pjetër duke kremtuar Meshën e shenjtë; shkuan në Kuirinale për të përshëndetur Presidentin e Republikës.

Në përfundim të punimeve zgjodhën Presidencën e re, duke falënderuar Presidencën e mëparshme dhe duke dërguar një mesazh.

Kjo është Presidencën e re e Presidentëve të Konferencave Ipeshkvnore Evropiane me Mesazhin e saj:

Arqipeshkvi i Vilniusit, Imzot Gintaras Linas Grušas, President i Konferencës Ipeshkvnore të Lituanisë është Presidenti i ri i Këshillit të Konferencave Ipeshkvnore Evropiane. U zgjodh nga Presidentët e Konferencave Ipeshkvnore Evropiane të mbledhur në Asamble Plenare, në Romë. Imzot Gintaras Linas Grušas, 60 vjeç, merr postin e Presidentit që më parë mbulohej nga Kardinali italian Angelo Bagnasco, i cili e udhëhoqi këtë Këshill nga viti 2016 deri në vitin 2021.

U zgjodhën edhe dy Zëvendës-Presidentët e rinj: Kardinali Jean-Claude Hollerich, Arqipeshkëv i Luksemburgut dhe Shkëlqesia e Tij Imzot Ladislav Némec, President i Konferencës Ipeshkvnore Ndërkombëtare të Shenjtërve Ciril dhe Metod në Beograd.

I urojmë punë të mbarë Presidencës së re.

Mesazhi përfundimtar i Këshillit të Konferencave Ipeshkvnore Evropiane në Asamblenë Plenare me rastin e 50-vjetorit të Themelimit të tij

Të ecim së bashku

Popuj dhe Kombe të Evropës, ne, ipeshkvij të Kishës Katolike të bashkuar me Atin e Shenjtë Françeskun, jua hapim zemrat tona dhe përtërijmë vlerësimin dhe dashurinë që kemi për ju si Etër dhe Barinj.

Jemi mbledhur në Romë me rastin e 50-vjetorit të Këshillit të Konferencave Ipeshkvnore Evropiane, një organizëm që Shën Pali VI e deshi



pas Konkilit II të Vatikanit si një shenjë e mëtejshme e vëmendjes dhe e afërsisë kishtarë me kontinentin e dashur.

Pranë varrit të nderuar të Pjetrit Apostull, të forcuar nga dëshmia e tij e gjallë dhe të konfirmuar nga fjalët e Papa Françeskut, ju drejtohem juve, vëllezër dhe motra të dashura, për t'ju thënë se jemi me ju dhe se misioni ynë na shtyn të ecim së bashku drejt së ardhmes së një kontinenti që lind nga një fat bukurie dhe qytetërimi, mirësie të përhapur dhe të konsoliduar në zemra, në tradita, në gjuhë: në thelb, në një ndjenjë të përbashkët, në një shpirt.

Siç dihet, historia evropiane është një ndërthurje harmonike veçorish që kanë gjetur sintezën dhe përmbushjen e tyre në personin e Krishtit, Shëlbuesit të botës. Kjo është një dhuratë që Provania ka bërë me ardhjen e Apostujve Pjetër dhe Pal, me dëshminë e fesë deri në derdhjen e gjakut dhe ka shkuar kudo përmes rrugëve dhe urave, shkëmbimeve dhe kërkimeve, liturgjisë dhe fesë së përbashkët. Pothuajse sikur Jerusalemi dhe Athina të gjenin vendin e bashkimit në Romë.

Sfidat e kohës, si p.sh. vështirësia për të dialoguar, mosbesimi në takimin e tjetrit, kultura dominuese materialiste, po shtypin si fenë e krishterë, ashtu edhe besimin fetar dhe në përgjithësi qytetërimin njerëzor. Nuk duhet të kemi frikë, por të jemi të bashkuar, dhe ne - si Barinj dhe Qytetarë - ecim me ju, individë, familje, Popuj, Kombe, për të qenë shërbëtorë të gëzimit tuaj. O Popuj që na dëgjoni, zëri ynë nuk është i fuqishëm, por mbart jehonën e shekujve: ka vetëm një emër për të kumtuar mbi çatitë e çdo shtëpie, Jezu Krishti. Ai është shpresa e vërtetë e Evropës, sepse është e vërteta dhe vetëm e vërteta na bën të lirë.



Ati i Shenjtë Françesku nuk resht së kujtuari se ne shpëtojmë së bashku dhe Evropa ka shumë nevojë për këtë mesazh. Na ftoi që të ndërmarrim udhëtimin sinodal për t'i dëgjuar të gjithë. Jemi angazhuar menjëherë për të organizuar një reflektim kontinental dhe mezi presim të dëgjojmë se çfarë do të na thonë popujt e Evropës. Kur ecim së bashku, kur kemi një qëllim të përbashkët, rritet respekti i ndërsjellë, zhvillohet durimi, ai që është përpara inkurajon, mat ritmin dhe nuk diktohet. Por qëllimi duhet të jetë i qartë, i fortë dhe i bukur, domethënë i lartë, i aftë për të magjepsur, për të kapërcyer vështirësitë dhe lodhjen, për të çliruar energjitë më të mira të secilit protagonist.

Askush nuk i frikësohet Ungjillit të Jezusit: ai na flet për njeriun dhe për Zotin, garantuesi i dinjitetit njerëzor, na kujton se askush nuk është vetëm dhe nuk duhet të jetë vetëm, se duhet të kemi një shikim preferencial për më të dobëtit. Na kujton se nuk ka liri pa tjetrin, as përparim, pasi secili është një e mirë për të gjithë: persona, familje dhe shtete. Pika e sintezës së kësaj ecjeje së bashku është te secili si

një dëshirë dhe te Zoti si një Parim: Ai nuk është xheloz për krijesën njerëzore, për dëshirën e tij për gëzim dhe pafundësi. Përkundrazi, është fillimi dhe fati i tij.

Në këtë përvjetor kaq të dashur, i ftojme të gjithë në Evropë: të ecim së bashku. Fjalët tona janë ato të fesë dhe gjithashtu ato të arsyes së vërtetë: vijnë nga i njëjti Burim, Fjala e Atit, Krishti Zot. Atje ku Ai është nuk ka periferi të harruara: aty ka Zot, besimtarë, njerëz me vullnet të mirë. Me ju shikojmë përpara, shumë larg, në mënyrë që të mos e humbasim rrugën dhe të mos ndalemi në përroskat e historisë. Së bashku shohim më mirë dhe ecim me përlësi drejt horizonteve të dritës dhe të paqes.



Don Nosh Gjolaj
Podgoricë

KULTIVIMI I DURIMIT DHE I NJOHJES- MOS TE SHKELET VIJA E KUQE!

(Pjesa e tretë)



3.Fuqia e marrëveshjes është në neve!

“Po qe se burri im ndryshon atëherë do të ishte gjithçka në rregull”. Po i njëjtin konstatim e kanë edhe burrat për grat e veta: “Po qe se gruaja ime është e drejtë dhe fisnike, jeta e jonë do të ishte krejtësisht ndryshe!”

Vërtetë gjendemi përpara një faktit: raporti dhe marrëdhëniet reciproke mes partnerëve. Zakonisht ne nuk i pranojmë njerëzit, as bashkë partnerin ashtu siç është, por dëshirojmë, ai të hyjë në kornizat e pikëpamjeve të mia, dëshiroj të jetë ashtu siç dëshiroj unë dhe jo si është ai në vetvete. Çka të bëjmë atëherë? Njeriut nuk mund t'i zëvendësojmë kokat. Po ashtu nuk mund t'i imponojmë pikëpamjet e tjerëve. Atëherë nuk na mbetet tjetër përveç ta pranosh tjetrin ashtu siç është. Me një fjalë tjetër duhet ta ndërrosh vetveten. Nuk mendojmë me këtë pohim, se partneri duhet të

shkrihet apo të asgjësohet në tjetrin, as të merret nëpër këmbë dhe t'i shkelet dinjiteti i tij nga tjetri, as ndërrimi i pikëpamjeve filozofike të jetës, as bindjet fetare dhe etiko-morale për hir të tjetrit t'i shkelësh. Por duhet të bindemi, ne jemi ata që i kemi çelësin në dorën, qoftë dialogut (bisedës) qoftë marrëdhënieve reciproke, qoftë marrëveshjeve. Parimisht duhet çdo njëri nga partnerët të fillojnë me reformën, pikërisht duke korrigjuar vetveten. Në qoftë se ia fillojmë me reformën e vetvetes, atëherë menjëherë do të bindemi, se situata fillon të ndërrohet: në vend të fajësimit, që zakonisht ia ngarkojmë tjetrit, tani e merr përgjegjësin mbi vete. Gradualisht fillon të lindin bindja se edhe tjetri ka të drejtë, dhe fillon ta pranosh ashtu siç është në realitet, dhe jo ashtu siç e dëshiroj me qenë. Fat lumturia e njeriut është në realizimin e vetvetes si person, kjo nuk vlen vetëm për ty por edhe për tjetrin që është përkaj tej. Atëherë nuk mbetet tjetër përveç të fillosh të luftosh

me vetveten duke ecur kah rruga e fisnikërisë dhe shenjtërisë. Kuptohet se nuk ka ndonjë iluzion, sepse nuk ka njeri në botë që ka lind shenjt, i pjekur dhe ideal, por me orvatje këtë e fiton gjatë jetës. Një fjalë e vjetër popullore thotë: “Për shamatë duhet me qenë së pakut dy veta!” Po qe se dëshiron njeriu ta gjejmë rrugën, e cila shpie te tjetrit, atëherë duhet ta marrësh çelësin e zemrës me vete. Ti duhesh e ta bindsh veten se nuk do të shamatohesh me tjetrin, dhe ai tjetri nuk mund të shamatohet me ty, në qoftë se ti nuk do. Për t’u kuptuar njëri me tjetrin nuk është e nevojshme me qenë dy veta, siç thotë G. Barbarini, në librin e njohur “Reforma e karakterit”. Në qoftë se njëri prej partnerëve fillon të mendoj mirë, mjafton për fillim. Atëherë mos prit nesërmen por sot, tani filloja me menduar mirë për tjetrin: “unë dhe ti, dhe gjithçka do të jetë mirë!” Konfliktet në bashkësinë martesore menjëherë fillojnë të shkrihen porsia akulli në ngrohtësinë e diellit. Mjafton vetëm prej një partnerit, ta vendosin baraspeshën mes vetes dhe tjetrit, në rastin tonë mes partnerit martesor. Ti je, ai njeri, që mund të bësh mrekulli, dhe jo ai tjetri!

Tregohet për një shembull të hershëm nga lashtësia, ku kishte jetuar një mbret, i cili e kishte një vajzë shumë të bukur dhe të hijshëm, po ashtu edhe shumë e zgjuar, por e mundonte një sëmundje jo e zakonshme.

Pasi ajo u rrit, vajzës i dobësohen duart, këmbët, sytë, veshët, dita ditët po i dobësohen edhe më keq. Mjekët e shumtë u munduan ta shërojnë, por pa sukses. Një ditë prej ditëve vjen një plak, për të cilin bisedohet i cili e njeh fshehtësinë e jetës.

Oborrtarët ia mundësojnë të shkojnë te vajza e mbretit për ti ndihmuar. Pasi plaku erdhi te vajza e mbretit. Ai ja jep vajzës një shportë prej thuprave që ishte e mbuluar me një rubë dhe i thotë: “Merre këtë shportë, dhe kije kujdes se çka është në të, dhe atëherë do të shërohesh.” Vajza e mbretit e merr shportë dhe me gëzim të madh e heq rubën dhe shikon se çka përbrenda. Kur e pa se çka përbën shporta ajo u brengos dhe ishte e zhgënjyer. Në shportë nuk ishte askush tjetër përveç një foshnje që qante, i cili ishte edhe më keq se ajo me shëndet. Mbretëreshës i vjen keq dhe kishte mëshirë për këtë, e merr foshnjën dhe e merr në duart e veta dhe filloi ta ngushëllojë fëmijën. Kalojnë ditët, javët, muajt dhe vitet. Vajza pa ndërprerë mendonte në foshnjën e sëmurë. E ushqente, e ngushëllonte, i buzëqeshte ditë e natë, duke vigjiluar mbi foshnjën bile edhe me sakrificat e mëdha.

Pas shatë viteve ndodhi diçka e papritur. Një prej ditëve fëmija filloi të buzëqeshë dhe të ecin. Vajza e mbretit e mori për dore dhe filloi të vallëzoj me

fëmijën, së bashku me fëmijën gëzohen dhe këndojnë. Ishte jashtëzakonisht e gëzueshëm për mundin shtatë vjeçar. Fëmijë ishte i bukur dhe vajza e mbretit ndjehet e fatlume, e bukur si asnjëherë tjetër. Aspak nuk ka vërejtur se ajo ishte shëruar.

Po e parafrazoi fjalët e ungjillit sipas Mateut 25,35-36:

O Zot, kur jam i uritur, më ço dikënd që mund ta ushqej.

Kur kam etje, më dërgo dikën, që kërkon ujë.

Kur kam ftohtë, më dërgo dikën që duhet ta ngrohi.

Kur vuaj, më dërgo dikën, që ka nevojë për ngushëllim.

Kur kryqi im bëhet i rëndë, më dërgo dikën, që do mund t’ia lehtësoj vuajtjet.

Kur jam i varfër, më dërgo dikën, që nuk ka asgjë.

Kur nuk kam kohë, më dërgo dikën, që në atë moment ka nevojën time.

Kur jam pa shpresë, më dërgo dikën që e ka humbur shpresën.

Kur kërkoj mirëkuptim, më dërgo dikën që duhet ta kuptoj.

Kur unë do të dëshiroja, që të tjerët të kujdesohen për mua, më dërgo dikën, për të cilin do të kujdesëm.

Kur mendoj për vete, mi drejto mendimet e mija kah të tjerët.

(Shiko Bozho Rustja, Zgodbe za skladien zakona in družhino, Ognjishçe 2015, fq.62)

4.Më mirë është të kesh qetësi se sa të drejtë!

Njeriu në mënyrë instiktive më parë e ka në gojë refleksin mbrojtës, siç është arsyeja, se sa e merr mbi vetën përgjegjësin: “Pse unë i pari me lëshuar pe!” Arsyeja shpërthen nga nënvetëdija vetvetiu në sipërfaqe. Te tjetri mund të shprehet i njëjti reagim: “Unë jam parimisht për pajtim, por pse gjithherë unë i pari, të lëshoj pe dhe ashtu më mbet barra, përderisa tjetri rron në djersen time, jo vetëm kaq, par më në fund edhe fryhet si gjel detit. Dikush di të jetojë, e tjetri vetëm vuan dhe bartë barrën!” Konstatimi i tillë në vetvete është i vërtetë, dhe nuk mendojmë as ta mohojmë. Por është e vërtetë edhe pohimi tjetër: drejtësia ka shumë përparësi, por edhe dashuria e tejkalon egoizmin e padrejtë. Derisa partnerët nuk vetëdijesohen, se dashuria është ajo rrugë, e cila shpie kah shpëtimi i



bashkësisë martesore, kah harmonia e përbashkët, deri atëherë do të vuajnë njëri nga tjetri, duke fajësuar tjetrin, i cili shfrytëzon, keqtrajton, vetëm murmurit në padrejtë që i bëhet nga ana e tjetrit.

Njeriu, i cilin nuk bindet me arsyeja e shëndoshat, dhe në fund të fundi edhe i refuzon çdo lloj dialogut (bisedës), atëherë e kemi para vetes një tip të rënd dhe i papërmirësueshëm. Ai si i tillë jo vetëm se është në konfliktin e përhershëm me bashkëshorten por edhe me mjedisin. Si fjala vjen, të vije mysafiri në shtëpi, dhe të kërkon drekën, por e porosit nikoqirin, mos ta përgatisin me krip, sepse vuan nga sëmundja e veshkave, dhe ti në mënyrë të vrazhdë i thua: “Ushqimi pa krip nuk ka shije!” Megjithatë, ia përgatit ushqimet me krip, do të thonë, se ti nuk je e aftë për dialog (për bisedë). Ti e ke drejtën tënde dhe pikë. Po qe se mysafiri shkon dhe nuk kthehet më te ti, as në kafe as në bisedë. Faji nuk ishte i mysafirit por i yti, dhe tani ti duhesh ta pranosh gabimin. Pothuaj se gjithçka varet, jo prej arsyes por prej pikëpamjeve të jetës.

Ja një shembull i imagjinuar:

Ndaje fatin tënd e do të bëhet i madh!

Një herë kisha ëndërruar një ëndërr të veçante. Unë isha një lypsar, dhe shkoj prej një dere në derën tjetër duke kërkuar lëmosh për ushqim. Në një moment e shikoj se si po afrohet nga larg dikush që nuk mund ta shoh qartas, pasi afrohet e vërejtja se ishte një karrocë e art mbretërore dhe pyes se kush

është ai mbret i mbretërve që më vjen për të më takuar. Në mua filloj të lindin një shpresë, më së fundit fati mu buzëqesh, nga një dhurues kaq i pasur që do të marr një lëmoshë të pasur, dhe ditë e vështira do të mbesin e kaluara. Karroca ndaloj para meje, dhe dëgjoj një zë: “Çka ke për të më dhuruar?”

Pyes veten, se çka është kjo, që më pyet mua lypsin që ti jap mbretit lëmosh. Çfarë mbretit është ky, sigurisht është një bracolët! Qëndroj i habitur dhe i pa vendosur, dhe pritshmëria e ime u ftohtë si dhe shpesa ime u shua. Fillova të shikoj se çka kam në strajcën time, ku kisha ca mys buke, veza, molla, një grusht oriz. Çka do ti jap? Në fund vendosa ti jap pakë oriz. Mbreti mori kokrrat e orizit, i puthi dhe ma kthej mbrapa dhe shkoi. Kur shikova kokrrat e orizit ishin kthyer në ar, kurse karroca e art ishte zhdukur. Atëherë fillova të qaj egoizmin tim dhe i pikëlluar akuzova veten time, pse nuk kisha aq guxim të jap të gjitha gjerat nga strajca ime!

Njeriu, i cili nuk është komunikues nga natyra, ai zakonisht me këmbëngulje qëndron në pikëpamjet e veta. Zakonisht i themi tipit tillë: krye fortë (kokëfortë). Kurse krye fortësia nuk është asgjë tjetër, përveç se e kemi përpara vetes njeriun e kufizuar. Tipat e tillë janë zakonisht të papërmirësueshëm, edukata nuk ndikon shumë për t'u përmirësuar. Ironia më e madhe është, kur ai,

arsyetohet me pretekstin e drejtësisë, gjoja ai është njeri me karakter të fortë dhe shumë i përpiktë. Parimisht ai qëndron me këmbëngulje principi kokëfortësisë. Përndryshe kishte me qenë nënvlerësim dhe poshtërsi po qe se i përulet tjetrit, dhe ia pranon vërejtjen, që ai tjetri ia drejton! Po ashtu kishte me qenë njeri labilë, po qe se e pranon gabimin ose fajin, sepse ai kurrë nuk gabon, nuk mëkaton, por gjithherë ai tjetri: “Në emër të vërtetës dhe të drejtës, unë nuk mund të lëshoj pe, nuk mund të komprometohem. Ku do të shkojmë, në qoftë se fajtori ka të drejtë! Ne të heshtim, përderisa fajtori ta ketë fjalën e fundit. Një gjë të tillë nuk e pranoj!”

Po qe se bashkë partneri i tij, e sheh, se partneri me të cilin e nda fatin e jetës është mjaft kokëfortë dhe këmbëngulës në ideja fikse të tija. Ai për hir të paqes në familje, (bashkësisë), kuptohet se nuk do të pajtohet me pikëpamjet e shtrembëruar, por as

nuk e dënon, por lëshon pe. Nuk paguhet shamata me njeriun e tillë. Sepse shamatën e shoqëron urrejtja dhe hidhërimi. Fund të fundit nuk është asndonjë shenjë dobësie, po qe se tregohesh zemërgjerë, i mirë dhe i durueshëm për hir pajtimit.

Njeriu apo çdo bashkëshort në martesë, duhet të vetëdijesohet, se nuk është vlara më e madhe të kesh të drejtë, por vlara më e madhe është “të jesh i mirë” si me partnerin ashtu edhe me tjerët ose me mjedisin. Po qe se ia arrite ta bindesh edhe partnerin, i cili vuan nga principi i një anshëm (kokëfortë). Kuptohet se drejta dhe drejtësia janë diçka të shenjta, por mirësia i tejkalon. Mirësia që e shoqëron dashuria është diçka e mrekullueshme. Me një fjalë është porsì zjarri që e dëbon të ftohtit! Në fund të fundit është më mirë ta pengosh urrejtjen, ankthin, frikën, pasigurinë, mëkatin se sa me qëndruar me këmbëngulje në drejtën tënde.

Mirësia është bija e dashurisë. Përderisa drejtësia pa dashuri dhe mirësi shumë lehtë shpie deri te dhuna. Njeriu, i cili nuk ka arsye të mjaftueshme, ai do ti përdorin edhe flakareshin (dhunën fizike e psikike) për ta bindur tjetrin.

Njëanshmëria e përkrahjes së drejtës, shpeshherë në shpie deri në konfliktet e shumta, që i shoqëron zakonisht urrejtja. Në të kundërtën vepron dashuria dhe mirësia: gjithherë duke ikur konfliktit, urrejtjes dhe dhunës. Ai vet nuk vepron ashtu siç vepron bashkë partneri kokëfortë, sepse dashuria dhe mirësia ecin me hapa të sigurt, për të mos hyrë në vorbullën e hapave të gabuar. Fjala e moçme thotë: “Më mirë është të kesh paqe dhe rahat se sa drejtësi dhe ferr!” Siç pohon Phil Bosmans: “Ne duhet të bashkojmë! Ta ndash bukën do të thotë: t’i ndash të mirat dhe pasurinë, mirëqenien dhe trashëgiminë, luksin dhe komoditetin. Vetëm buka e ndarë ka shije më të mirë.” (Lulet e fatit duhet t’i mbjellësh vetë, Shpresa, Prishtinë 2002, fq. 52)



Moter Marjeta Gjoka

Punëtore e Vogel e Zemrave të Shenjta

TË NJOHIM TË VËRTETËN DUKE E DASHUR ATË

«[...]Do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do t'ju bëjë njerëz të lirë»(Gjn 8, 32).

Nisemi nga një bindje besimi e shprehur me fjalët e Shën Basil: «Ne na propozohet që ti përngjajmë Hyjit, aq sa i është e mundur natyrës së njeriut. Por ngjashmëria nuk ekziston pa njohuri» (BASILIO, *Shpirti Shenjtë*, I,2). Si njohja ashtu edhe përmbushja e planit Hyjnor janë të mundshme vetëm falë Frymës së Shpirtit Shenjtë që zhvillon aftësinë përbërës të lindur tek njeriu, dhe kjo deri në përmbushjen e dëshirave për tu bërë si Hyji (Krh.

Njohuri integrale dhe njohuri e pjesshme

Për filozofin Rus Vladimir Solov'ëv nevojshmëria për një njohuri integrale duhet të ketë karakterizuar qasjen e të krishterit për studimin, i cili ky studim konsiston për të kuptuar nisjen nga uniteti dhe për të arritur tek uniteti. Në fakt, njohuria është e mundur sepse ekziston një unitet i realitetit në origjinë, kështu që unë mund të njoh dhe për këtë arsye qëllimi i dijes është që të arrijë në unitet, duke zbuluar lidhjet midis gjërave, duke favorizuar në jetë këtë unitet, o më mirë të gjithë unitetin, jashtë së cilit bota do të ishte si një



BASILIO, *Shpirti Shenjtë*, IX, 23). Shpirtërimi i studimit është i rrënjësuar në këtë siguri, jemi të thirrur të njohim Hyjin dhe planin e Tij dhe kështu të përmbushim dëshirën tonë të ngjashmërisë me Krijuesin tonë. Me fjale të tjera, i krishteri beson se krijimi është vepër e Një të Vetmit Hyjit Atë. Argumenton se i gjithë krijimi mban gjurmët e Krijuesit, e din që eksperiencia e Krishtit që është i Biri dhe njeh të Atin i cili i ka dhënë fuqi mbi çdo gjë, ekziston pra një logjikë midis besimit tek Ati dhe mënyrës së njohjes si bir, një qasje integrale ndaj dijes është tipike për ata që e konsiderojnë realitetin si një unitet dhe unitetin si hapësirë të jetës së unifikuar.

pasqyrë e thyer dhe e gjithë njohuria do të ishte e pjesshme, dhe, në një farë mënyre e paqartë. njohuria integrale është ajo në të cilën marrin pjesë të gjitha shqisat, kështu që ekziston një korrespondencë midis realitetit dhe njohurisë. Është një sintezë, e aftë për të revolucionarizuar mendimin njerëzor, një sintezë që lejon gjetjen e itinerareve të reja ende të panjohura që duhet të rinovojnë ndërgjegjen njerëzore. Në të kundërtën ekziston kritika e një forme të dijes, dhe e kulturës, që e favorizon interesin egoist, dhe të vetëm, fakti rastësor atomizmi i detajuar e i ngushtë në jetë në shkencë dhe art, një kulturë që përpunon forma të veçanta dhe materiale të jashtme për jetën, por nuk

jep një përmbajtje të brendshme të vetë jetës, pasi nxjerr në pah disa elementë të vetëm, i sjell ato në shkallën maksimale të zhvillimit aq sa është e mundur në ndarjen e tyre, por i lë pa një lidhje organike dhe për këtë arsye pa një shpirt të gjallë kështu që e gjithë kjo pasuri është një kapital i vdekur (Krh. V. SOLOV'EV, *parimet filozofike të njohurive integrale, mbi njerëzimin-hyjnor dhe shkrime të tjera*, Milano 1971, fq 48). Një njohuri e pjesshme është sikur një kapital i vdekur. Për shembull, njohja e gjërave, (shkenca), njohja e ligjeve, (o e fenomenëve), njohja e ideve (ose e metafizikës) etj, sepse nuk jep qasje në ndjenjën e fenomeneve, nuk jep autoritet mbi zbatimin e ligjeve, nuk të çon në opsionin për të vërtetën e intuitës në filozofim. Kështu që mund të ketë nga ata që njohin dhe nuk kuptojnë, kush njeh dhe nuk ka fuqi, kush njeh dhe nuk jeton. Për çfarë shërben atëherë një studim duke pasur parasysh këtë lloj njohurie?

Fatkeqësisht ka edhe në mesin e të krishterëve që e konsiderojnë njohurin e pjesshme një qasjeje që nuk ka asgjë shpirtërore ose integrale. Studimin e konsiderojnë një ushtrim i thjeshtë përfundimtar të një rruge administrative dhe jo formuese, vlerësohet për fuqinë që jep, për dobinë e menjëhershme dhe si parantezë në një punë etj. Sipas mendimit të disa të krishterëve ata që studiojnë janë selektivë, ideologjikë, dhe agresiv, sipas këtyre tipave studimi nuk ndihmon për të jetuar por të shpërqendron. Që nuk të lejon të hysh në histori por në iluzionin e një gjeometrie të përsosur mendore që shembet sapo të vijë prova e parë serioze e jetës. Duke mos i dhënë rëndësi studimit dhe duke e konsideruar llojin e qasjes për të studiuar si dytësore, prania e të krishterëve në fushat kërkimore është zvogëluar dhe incidenca e të menduarit mbi temat e jetës dhe të relacioneve njerëzore është shumë e vogël.

Dashuria garanci e së vërtetës

Mishërim - Shndërrim - Zbulim – Profetizim janë horizontet shpirtërore të një qasjeje integrale ndaj njohurisë që sot është një profeci e mundshme në fushën baritore intelektuale. Mendoj që duhet të angazhohemi shumë me studimin ndaj atyre pikave që i përket dialogut me kulturën, të kemi konsiderata të reja me krijimin dhe me traditën. Nëse kriza më e madhe sot është ajo e relacioneve njerëzore, për të qenë të pranishëm si dëshmitarë dhe apostuj, të krishterët para së gjithash duhet të jenë njerëz të aftë për relacion, por edhe njerëz që kanë një qasje integrale ndaj dijes. Ajo çfarë duhet të na mendojë edhe ne që kemi arritur një ecuri

është, si t'i ndihmojmë ata njerëz që janë vendosur pranë nesh për të gjetur dashurinë aty ku po u komunikojmë njohuri atyre? Si t'i ndihmojmë ata të preken nga Hyji i gjallë ndërsa përpiqen të lidhen me misterin e Hyjit shpëtimtari i Krishtit domethënies Kishës?

Për të gjetur dashuri aty ku komunikohet njohuria! Studimi është tërheqës dhe njohuria është e besueshme nëse në të gjendet dashuri. Që më përpara Evagrio pohonte që dashuria është dera e njohurisë së vërtetë (krh. EVAGRIO, *Le traité pratique*, Prologue, in SC, 171 (1971) 492), sepse dashuria bën të mundur kapërcimin e distancës midis lëndës që ai njeh. Dashuria është konkrete, është personale, është jetë, prandaj tipi i njohurisë do të jetë integral pasi merr parasysh disa aspekte të realitetit dhe të gjitha sipas personit. Ajo që shtyn në levizje njohurin nuk është kurr e lidhur me "unin" si me dashurinë. Nicolas Berdiaev shkruante që mund të konsiderohet dashuria si parim i njohurisë së vërtetë sepse nuk vendos "unin" në qendër por "ne" si themelin e mendimit. Arrin që të shprehët duke thënë, që «jo mendimi, por dashuria e aprovon ekzistencën time», (krh. N. BERTIAEV, *Ideët ruse*, Paris 1969, 169). Është i mundur një shpirtërim studimi në perspektivën e një njohurie ndaj besimit të vërtetë, nëse dashuria është burimi, kjo do thotë që është "një garanci e së vërtetës" në krahasim me atë që propozon, bashkim përmes dashurisë kishtarë dhe pajtuese. Këto janë kriteret për një qasje integrale ndaj njohurisë, është në sajë të dashurisë që i gjithë realiteti shfaqet i bashkuar dhe njohuria mund të jetë integrale dhe të "njohë të vërtetën".

Vëmendje për tu privilegjuar

I krishteri që studion dallohet nga kush mëson një lojë fjalësh dhe konceptesh, sofizmat e paqartë dhe në modë, dallohen nga kush shet arsyetime të paaftha dhe të pa testuar në zjarrin e jetës së përditshme, nuk aspiron të hyjë në atë kategori studentësh ose studiuesish të admiruar për aftësitë e tyre intelektuale dhe për këtë arsye të përjashtuar nga çdo gjykim mbi jetën e tyre, mbi koherencën midis besimit dhe studimit.

Mund të kujtojmë këtu tre vëmendje për t'u privilegjuar në studim për një qasje integrale ndaj njohurisë.

Vëmendja e parë, të konsiderojmë eksperiencën e shenjtërve. Për shekuj, krahas Shkrimit të Shenjtë, studimi i murgjve orientalishtë ishte i kufizuar në *filokali*, e cila është si një enciklopedi e përvojës shpirtërore shpëtuese ku të tjerët mund të marrin si në një shkollë urtësie. Urtësia që na vjen nga e

kaluara dhe nga të tjerët nuk duhet të përbuzet, mbi të gjitha sepse na transmeton një urtësi të provuar me kalimin e kohës dhe të miratuar me kalimin e kohës nga Kisha.

Vëmendja e dytë, krahasojmë studimin me cilësinë e relacioneve. Përmbajtja është mënyra e transmetimit të njohurive që përkojnë. Nëse përmbajtja e studimit është shpëtimi, mënyra e studimit duhet të pasqyrojë rrugën e shpëtimit që janë Pashkët dhe Rrëshajët. Ndjenja e studimit, falas, si "shërbim" dhe kujdesi për çdo frymëzim do të ndihmonte për të kapërcyer shumë *ngërçe*!

Vëmendja e tretë, e konsideron të domosdoshme verifikimin e jetës shpirtërore. Nuk ka asnjë lëndë studimi që mund t'i përjashtojë ata të cilët studiojnë për ruajtjen e dhuratës së çmuar që është jeta e tyre shpirtërore, besnikëria ndaj lutjes dhe luftës shpirtërore. Nga inxhinieria elektronike te teologjia, të krishterit i kërkohet dashuria për Hyjin dhe për të tjerët, dashuri për krijimin, preokupim për njerëzit që e rrethojnë, kujdes për vlerat e Mbretërisë së Hyjit, dialog me këdo dhe i hapur ndaj Transcendencës, shërbim ndaj të varfërve, kujdes për mëkatarët sipas thirrjes së tij.

Në ecje drejt së Vërtetës

Përmbajtja e studimit nuk është informacion nënshtrimi, por për kundrazi studimi është pasurim, nëpërmjet studimit i krishteri mund të njohë më shumë por mbi të gjitha vizioni i tij mund të jetë më

i hapur ndaj dialogut dhe relacionit me të tjerët, e mbi të gjitha me Hyjin. Kush studion mund të dëgjojë këshillën e Profetit Baruk kur popullin e Izraelit e pyet duke i thënë: përse je në token e armikut? «[...] po përdhosesh me kufoma, i çmuar si ata që në Nëntokë zbritën! E le burimin e dijes! Të kishe ecur udhës së Zotit, do të banoje në paqe të përhershme. Mëso ku është mençuria, ku fuqia e ku kuptimi, që një herë e mirë ta dish ku është jeta e gjatë, drita e syve edhe paqja», (Bar 3, 10-14). Flitet për të rigjetur atë dituri që është *kujtimi ndaj Hyjit* ku në gjirin e tij të shenjtë gjithçka që ekziston, jashtë Tij nuk ka jetë të vërtetë. Të krishterët studiojnë për t'u bërë njerëz të aftë për tu bashkuar, me një dituri të hapur dhe pozitive ndaj botës së sotme. Një aftësi e tillë për të shqyrtuar dhe për të bashkuar është një nga burimet e qytetërimit të krishterë. Edhe në botën e sotme ka shenja të paqarta, shenja që ndërsa tregojnë një rënie, ka edhe nga ato që mund t'i hapen shpirtit dhe të jenë një mundësi e madhe për shpalljen e krishterë. Për të lexuar dhe kuptuar këto shenja, dhe për të zbuluar udhët e shpirtit dhe për t'i komunikuar botës një *Fjalë* jete, duhet një ecje e vërtetë dhe drejtë së Vërtetës. «Biro, nëse do të kesh qëndresë, do të bëhesh i ditur e, nëse do të jesh i censhëm, do të bëhesh i urtë. Nëse të pëlqen të dëgjosh, edhe do të mësosh dhe, nëse do t'i vësh vesh, i urtë do të bëhesh» (Sir 6, 33-34).



Giovanni Cucci S. I

E VËRTETA, NJË VIRTYT I LËNË NË HARRESË Një pasqyrë e një realiteti kompleks

Mes virtyteve fetare, që janë: *kujdesi, drejtësia, fortësia, qetësia*; drejtësia në fakt është i vetmi objekt aktual i betimit nga pikëvështrimi i reflektimit filozofik. Kjo ndodh veçanërisht falë ripozicionimit të kontraktualizmit në vepra të reja. Kjo është një tentativë për ta prezantuar problematikën duke filluar nga një perspektivë metafizike besimtare, duke gjetur kritere vlerësimi që e lejojnë çdo njeri të jetë një i lirë racional dhe i barabartë. Një propozim, i cili mund të zbatohet në një shoqëri komplekse, ku mungon një vizion i jetës së bashkëndarë.

Në një mënyrë të tillë, sipas filozofisë neo kontraktualiste, drejtësia mund të vendoset në jetën shoqërore, përmes një tipi preciz dhe mirëkuptues. Kjo është një kontratë fikse, në të cilën individët dukshëm të ndryshëm për sa i takon ndjeshmërisë, zakoneve, aspektit kulturor dhe besimtar, mund të bien dakord për kritere të caktuara të burimeve dhe kursimeve. Bëhet fjalë për një propozim interesant, i cila kërkon që të vijë kundër vetë situatës, ku karakteristikat duket që janë të destinuara për t'u bërë gjithnjë e më shumë relevante në nivelin politik dhe shoqëror.

John Rawls, një nga përhapësit më të ndritur të neo kontraktualisteve filozofikë, në veprën e tij të parë "Një teori e së drejtës", duke hyrë në mes të problematikës, mes pozicioneve të dukshme, drejt pozicioneve të ndryshme, ka shpikur termin "pëlqim për kryqëzim", si një vend i mundshëm

takimi mes mendimeve të ndryshme. Për filozofin, pëlqimi duhet t'i limitohet drejtësisë shoqërore, me fjalë të tjera duhet që të vendoset filli i drejtë për të zgjedhur të mirat e pafundme për një jetë të ndryshme, ashtu si konceptohet rinjohja mes të drejtave të pranisë, udhëzimit, lirisë të së shprehurit, e të ushtruarit të profesioneve të ndryshme, si: politike, kulturore, fetare. Fakti që lidhemi me profesione të ndryshme nuk na pengon që të arrijmë në një marrëveshje. Është e domosdoshme që të krahasohen bindjet personale, që mund të përdoren vetëm në ambientin privat.

Për të pranuar ushtrimin e bashkëndarjes, Rawls interviston të famshmin shpërndarës të "velit të injorancës", pasi askush nuk di se ku do të shkojnë të mirat-objekt kontraktues ky. Ajo e Rawls, është një version i modelit të lirë, sipas të cilit konceptimi më i zakonshëm i jetës ka të bëjë jo vetëm me mjedisin e ndërgjegjen personale, por edhe pa ndikimin në asnjë mënyrë të dimensionit shoqëror dhe politik. Megjithatë filozofi nuk i konsideron absolutisht të pavlera të tilla propozime, madje është krejt e kundërta, puna për arritjen e së drejtës ka të bëjë me një sjellje etike thelbësore, të besimit dhe bashkëpunimit, në përballje me anë të tjera dhe mund të inspirohet me pozicione të ndryshme fillimesh. Puna për t'u arritur e mira e përgjithshme është një vlerë që duhet të bashkëndahet dhe është e pazëvendësueshme për komunitetin shoqëror. Në këtë



kuptim, pikat e ndryshme të takimit, mbesin të padukshme në planin e dakordsisë, por mund të tregojnë aspekte të ndryshme të problemit, të aftë për të respektuar kompleksitetin.

Ajo që Rawls ka në zemër është tutela e lirisë personale, edhe pse në fakt është e vështirë se si të vihet në zbatim në një shoqëri të tillë. Idealja do të ishte se si të jetohej në një shoqëri të drejtë, ku respektohen të drejtat e të gjithëve. Në një shoqëri të tillë njerëzit do të kishin lirinë maksimale, të krahasueshme me lirinë që tjetri ka. Ajo që njeriu mund apo duhet të bëjë me një liri të tillë, duket se është një çështje private, në njëfarë kuptimi, subjektiv, pasi është duke u respektuar kërkesat e drejtësisë, duke supozuar se nuk mund të njohin në detaje atë që është e mirë për njerëz të veçantë dhe as nuk kërkohet një dakordësi në lidhje me këtë çështje.

Është e mundur një qasje kontraktuale me drejtësinë?

Libri i Rawls ka pasur një sukses të madh dhe për të kanë lindur debate filozofike dhe politike. Interpretimet e radhës kanë vlerësuar së shumti anën tjetër të propozimit. Një rrezik jo i rrallë për reflektimin filozofik.

Mbi të gjitha një qasje e tillë, për aq kohë sa prezantohet si formale është e limituar që të theksojë dimensionin e drejtësisë. Një çështje që nuk mund të lihet në vendin privat të ndërgjegjes. Propozimi i kontratës sociale, në fund të fundit rrjedh nga këto të mira që teoria e së drejtës duhet t'i garantojë. Kjo bëhet e dukshme në rolin e *maximit* (duhet të vlerësohen maksimalisht ato që janë më keq), që luan një rol vendimtar në argumentimin e tij. Ajo nuk është e redaktueshme në një procedurë thjeshtë ekonomike, të sistemimit të burimeve, por ajo vazhdimësisë i jep një karakteristikë të qartë morale. Pastaj bëhet impotente ndaj zgjedhjes konkrete. Amartya Sen jep shembullin e tre fëmijëve që duan të vetmin flaut ekzistues, duke dhënë tre arsye të ndryshme: mundësi, pronësi, varfëri. Të tria janë argumentime të sakta njëloj, kjo gëlltitje është një problem tipik, bazuar në rregulla dhe përkufizimeve rigoroze, por që nuk e kanë mundësinë që të drejtojnë konfliktualitetin rreth dhënies të së drejtës njerëz, në situata edhe më komplekse sesa të flautit.

Propozimet etike janë të fshehura, por të pashmangshme. Ato i referohen qartësisht vetë strukturës së veprës. Dy principet themelore të së

vërtetës ekspozohen para momentit thelbësor, vellos së injorancës, pa i dhënë atyre një justifikim. Me fjalë të tjera, ato nuk janë të kundërta. Këtu dallohet pika vendimtare: kush vendos, çfarë bën dhe si mund ta realizojë qëllimin. Në fund, diskutimi mbi të mirat e mundshme, mbyllet sipas një modeli të vendosur që më parë. Lista është një listë e ndërtuar dhe është produkti i një historie të doktoraturës; mbyllja e saj është efekti i ndërtimit. Në këtë mënyrë pretendohet që të rregullohet jeta e qytetarëve, pa pasur mundësinë që ato të kryejnë ndonjë nga hipotezat e librit.

Praktikisht kush ndjek udhëzimet e duhura, pa thënë asgjë rreth kushteve që e bëjnë të drejtë një shoqëri, e jetojnë dhe përfjetojnë jetën reale të njerëzve dhe vështirësive që e ndjekin. Mungon një aluzion në edukimin e njeriut, që e bën të aftë për të bërë zgjedhjet e duhura. Kjo është një çështje prezente te antikët, të cilët insistonin në qarkullimin e jetës morale. Drejtësia nuk mund t'i ndahet virtyteve të tjera, vetëm një burrë i drejtë mund të veprojë në mënyrën e duhur, deri në pikën sa të sakrifkohet për të mirën e përgjithshme. Në momentin që bëhet virtyt vetjak, drejtësia kthehet në reflektim mbi korrektësinë e procedurave formale; një aspekt ky tepër i rëndësishëm, por që e boshatis nga karakteristikat e veta ekzistenciale, edhe e bën një artikulum artificial.

Zgjohej në fakt, disa dyshime mbi vallon e injorancës; është mahnitëse se si një nocion kaq imagjinar dhe hipotetik formon shpinën kurrizore të të gjithë veprës. Kjo na bën të mendojmë më së shumti për mitologjinë sesa për shkencën politike. Tradita e një konceptimi të përgjithshëm të njeriut dhe jetës është një çështje e pashmangshme për të përballuar çështjen e diversitetit -tematikë kjo thelbësore e shoqërive aktuale.

Konceptimet e liberale të lirisë

Pikërisht ky është aspekti më problematik i një propozimi të animuar nga motive mahnitëse. Pyetësi rreth pyetjes se çfarë duhet të bëjmë me një liri të tillë, pra një traditë pozitive, do kërkonte kuptimin e "qëllimit" dhe një etikë të karakterit teologjik, duke hyrë në një horizont më kompleks të pranimit kontrovers.

Mungesa e një prospektive të tejkaluar, që i bën problematike vetë themelet e shoqërisë së lirë, që për t'u përballuar në mënyrë të saktë, kërkojnë që të kalohet koncesioni i një të drejte të aftë për të formuar veten dhe të tjerët. Një arsye e këtij tipi,



rrezikon që të qëndrojë në heshtje për çështjet vendimtare të bashkëjetesës civile. Këtu duhet të mendojmë për temën e emigrimit, të varfërive të reja, të asistencës sanitare, të vullnetarizmit, të akomodimeve të qendrave të dëgjimit, të ndërmjetësimit në nivelin e politikës internacionale, etj.

Vlerat që janë bazë e së drejtës: liria, barazia, dinjiteti i çdo qenieje, tërësia e të drejtave njerëzore, mbrojtja e më të dobëtëve, që janë të privuar nga justifikimet, bëhen të mundimshme për t'u mbështetur dhe përfundojnë duke qenë të keqkuptuar apo të vendosur në mënyrë arbitrare nga vullneti i ligjeve.

Filozofi i të drejtave, Ernst Wolfgang Bockenforde, ka shprehur këtë pohim "Shteti i lirisë jeton me supozime, të cilat nuk mund t'i garantojë. Ky është rreziku i madh që është shtuar për hir të së vërtetës. Nga njëra anë ai mund të jetë si shteti i së drejtës, vetëm nëse liri, e cila i garantohet qytetarëve është e disiplinuar në brendësi. Ia vlen të theksohet që nis me substancën morale të individit dhe me shoqërinë homogjene. Nga ana tjetër ama, nëse shteti kërkon që të garantojë nga vetja këto forca rregulluese të brendshme, ajo heq dorë nga liria vetjake dhe bie, në një plan shekullor, në vetë hapësirën e tërësisë nga ku ishte tërhequr nga luftërat civile.

Është ajo që është e quajtur "Parajsa e Bockenforde", një shtet, për të qenë i lirë, duhet që të justifikojë të drejtat që reklamon, në nivelin juridik. Për të bërë drejtësi, duhet të heqë dorë nga një përdorim tekniko-instrumental të së drejtës, për

t'i lënë hapësirë një njohurie të mundshme. Nga një analizë e fundit, konstatojmë se konceptimi pozitivist i së drejtës e ka përjashtuar atë që në fillim. Ky paradoks, i formuluar përgjatë një Konference të mbajtur në Ebrach, në vitin 1964, mbart qendrën e vëzhgimeve të tij, gjë që ka ardhur si rezultat i një debati dhjetëvjeçarit të fundit, nga autorë të ndryshëm pasardhës.

Një shembull i vështirësisë që e paralizon reflektimin mbi drejtësinë e mbi çështjen e dinjitetit të njeriut e të drejtave njerëzore

Nëse nuk del nga një dilemë e tillë, shteti i lirë rrezikon të vdesë si demokraci, duke i dhënë përparësi disa devijimeve të rrezikshme, siç janë mbipopullsia dhe substancat e forta, që e zhvillojnë debatin. Mbi të gjitha shteti, për ta kaluar këtë, përfundon duke marrë ato gjëra, prej të cilave do të donte që të distancohej. Një shtet i cili vetëshfajësohet, bëhet totalitar dhe i rimohon zotërimet thelbësore të fituara gjatë epokës moderne.

Një aplikim i mundshëm: të drejtat njerëzore

Një tjetër shembull vështirësish që paralizon reflektimin është çështja e dinjitetit të njeriut e të së drejtave njerëzore. Tematika që në vëzhgim të parë duken që nuk kanë pse të diskutohen, por që në të vërtetë vendosin vështirësi të mëdha, në momentin kur përfshihen implikimet filozofike. Justifikimet e tyre do të kërkonin mbi të gjitha braktisjen e një përkrahje materialiste.

Nëse qeniet njerëzore nuk do të ishin të

ndryshme nga çdo organizëm tjetër i gjallë, bie poshtë vetë ideja e së drejtës. Cili kërkim epik do të mund t'i tregonte? Ajo vetëm mund të konstatojë që njeriu është një përbërje e materies organike, si çdo njeri tjetër, por tregimi se ai është racional, i lirë dhe i njëjtë, dhe se është i aftë për të zgjidhur çështjen, vendos vështirësi të tjera. Është domethënëse që Rawls nuk përfshin njerëzit me vonesa mendore, subjekte të së drejtës, ku dihet të vendoset drejtësia; por përfshin ato njerëz që janë në mungesë të aftësive racionale, ato nuk kanë vizion kulturor dhe duhet të vendosen në të njëjtin rang me kafshët. Të tillë njerëz janë një objekt i shekullit të kaluar të së drejtës: ato mund të kuptohen vetëm në aspektin shoqëror dhe ekonomik.

Të drejtat dhe dinjiteti mund të kenë një status real, vetëm nëse qeniet njerëzore janë pak më shumë se material biologjik. Diskutimi shekullor modern mbi të drejtat njerëzore varet nga aftësia për t'i ruajtur në njëfarë mënyre, por pa e njohur, besimin që çdo qenie njerëzore është i krijuar për të imagjinuar ngjasimin me Zotin. Bazat themelore intelektuale të botës moderne po duken gjithnjë e më pak, pasi pohimet metafizike që i udhëheqin, të kombinuara me zbulimet e shkencave natyrore, nuk ofrojnë të drejta për të besuar në anën morale, politike dhe normative më bazike.

Njerëzit e “ateizmit të ri”, përballë problematikave të tilla, nuk e fshehin parehatinë e tyre, për të pohuar se nuk mund të ketë një përgjigje racionale. Pavarësisht finesës së tij intelektuale, Ronald Dworkin, i përgjigjet pyetjes mbi të vërtetën e ekzistencës objektive, të të drejtave natyrore, ashtu sikurse një prift bëhet konfuz nga një laik i papërgjegjshëm. Më e mira gjë që mund të bëjmë është që të besojmë.

Norberto Bobbio mund të konsiderohet si përfaqësuesi më i ndershëm dhe i ndritshëm i kësaj periudhe. Ai flet për kërkimin e mbi këtë temë sikur të ishte një iluzion. Të drejtët nuk kanë themel, nuk justifikohen, ruhen nga institucionet politike me anë të një akti të tatueshëm. Filozofia nuk është në gjendje që të shtojë gjë tjetër. Kur kemi arritur në normën e normave, ky çon në fuqinë e fuqive, në sensin që një urdhër juridik është i tillë vetëm nëse është më efikas në ndeshjen e armatosur, që pretendon që ta marrin fuqinë, por që nuk ia arrin. Duhet madje dhe të njohim, se ajo që mbyll sistemin nuk është norma, por fuqia. Bobbio megjithatë nuk mund të bëjë asgjë tjetër përveçse të përballë me çështje të tilla në momentin kur

përpiqet që të mbrojë të drejtat nga devijimet e dhunshme dhe totalitare. Vlerat e fundit nuk justifikohen, fitohen: kush është i fundit, nuk përbën asnjë problem. Të flasësh ama për “vlerat e fundit”, kërkon që të justifikohet me anë të ligjit dhe të vlerave, nga momenti kur sjell për popullin detyrimin për t'u përfshirë dhe respektuar. Nuk është shumica ajo që vendos se njerëzit janë të lirë dhe të njëjtë, pra nuk është shumica ajo që vendos të kundërtën. Duhet të njihet një horizont më i madh i njeriut të aftë për të garantuar vlerat në të. I fundit, sipas kuotimit të Babbios, është pikërisht themeli i fundit: ai i cili duke mos ia dërguar tjetrit formon të pakushtëzueshmen, absoluten, që formon gjithçka. Përgjigjja e pyetjes mbi bazën e të qenit të njëjtë, ashtu si edhe të të drejtave të njeriut, duhet kërkuar në planin absolut.

Përse duhet të jemi të drejtë kur bota është e padrejtë

Është e vështirë t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje, pasi mendja na shkon te tragjeditë dhe padrejtësitë që bota na prezanton. Problemi i një të drejte neo kontraktualiste, rrjedh pikërisht kur të tjerët nuk bien dakord, çfarë të bëjmë në të tilla raste? Përse të jemi të drejtë, në një univers, ku një pjesë e madhe është e padrejtë? - pyeste Louis Kohlberg. Koherenca me vlerat nuk mund të paguhet, të paktën në këtë jetë. Shembujt më të mëdhenj janë të gjitha figurat e njerëzve që historikisht kanë dështuar. Situata të këtij tipi, të ashtuquajturat situata asimetrike, të padrejta pasi janë të pabarabarta, formojnë paradigmen qendrore: të duam armiqtë tonë, bëni të mira, dhuroni pa pritur gjë në këmbim. Problemi për të përballuar asimetrinë, për të marrë vendime që sjellin dëme personale, është një pararendje e vetë vdekjes dhe lidhet me të tjera çështje.

Ligji natyror laik, i lindur në kundërvënien të traditës klasike-mesjetare, e ka parashikuar që në rrjedhë të saj një vështirësi të tillë. Pa pasur garancinë e një urdhri nga lart, fuqia e sovranit mund të përhapet deri në kapriço, duke u bërë tiran. Bentham, duke kritikuar ligjet e të drejtave njerëzore e të qytetarit të asamblesë franceze, vëzhgon, në koherencë me importimin e vet. Nuk ekziston një ligj universal, nëse e drejta nuk është gjë tjetër veçse komanda e sovranit, atëherë do të ketë shumë të drejta, aq sa ka dhe sovranë.

Me mendjemprehtësi, përfaqësuesit e kësaj shkolle konstatuan sa shumë ishte e nevojshme që



të përfshish një princip absolut, që është i aftë të miratojë me racionalitet dhe ligje në mënyrë që të diferencohemi nga dhuna. Nga këtu, vihet re interesi në lidhje me teologjinë, të paraqitur nga përfaqësuesit më të njohur të së drejtës natyrore laike-shekullore. Janë premtimet teologjike ato që bëjnë konferenca për të garantuar laicitetin e propozimit të tyre, si për shembull justifikimi i fuqisë absolute të sovranit, të drejtuar nga Zoti.

Dialogu evangjelic i shkruar në kohë jo të dyshimta, përfshin disa pika qendrore të debatit aktual në lidhje me legjitimitetin e fuqisë. Ajo që Giovanni përshkruan është një proces formal, i privuar nga brendësia etike. Ky boshllëk është pengesa themelore e ushtrimit të së drejtës, e kthyer në interes vetjak, që është vetë pozicionimi si mes Pilatit dhe çifutëve. Të dyja palët për të vazhduar, duhet që të fitojnë të drejtën, të aktrojnë.

Ka edhe një pikë të rëndësishme në këtë rrëfim. Jezusi tre herë thekson se është mbret në një mbretëri që nuk është e kësaj bote. Bota për të cilën ai flet nuk është se nuk gjendet në këtë botë, por ka një origjinë të ndryshme. Ajo ka një sërë vlerash, që bota nuk mund t'i kuptojë. Ky ndryshim përfshin si Pilatin ashtu dhe çifutët. Pilati ka frikë dhe çifutët janë të skandalizuar. Jezusi e manifeston mbretërimin e tij, jo si një përparësi vetjake, por për

hir të së vërtetës. Një term ky që për të rinjtë ka interpretime të ndryshme, si: drejtësi, liri, besim në Zot. Një e vërtetë që rrjedh nga lart, nga vetë Zoti. Një e vërtetë që nuk mund të injorohet, pasi është themeli i çdo fuqie ligjore. Vijimësia e procesit paraqet një kontrast të madh mes Jezusit e Pilatit: për Jezusin nuk ka asgjë më të rëndësishme se e vërteta, për Pilatin përpara së vërtetës vjen arsyeja e shtetit.

Si përfundim, drejtësia e shtetit duket që është mbizotëruese, por është e mbushur me gjak të pafajshëm. Siç vë re Benedikti XVI, drejtësia nuk mund që të realizohet pa të vërtetën; mund të përfshihet vetëm ndonjë ditë më vonë. Pa një vijimësi të tillë, që na çon te një dimension mbitokësor edhe protesta kundër padrejtësive, sado që e admirueshme, do kthehej në një frymë sterile zëri.

Pajtimi kundër kontraktualizmit të së drejtës vë në dukje një seri problematikash që rrezikojnë të gërryejnë institucionet demokratike të së sotmes. Çështje sigurisht komplekse dhe që nuk janë të lehta që t'i organizosh, por nga ana tjetër nuk mund të shpërfillen në mënyrë absolute.

Përktheu: Bernardina Shahini

Material i përkthyer nga revista kulturore – fetare “*La civiltà cattolica*”, 2021.

PROGRAMI SHQIP I RADIO VATIKANIT SOT MBUSH 70 VJET!

Ju flet Radio-Vatikanin në Gjuhën Shqipe! Ju uron paqe e të mira! Të dashur miq. Laudetur Iesus Christus - duke lavdëruar Jezu Krishtin fillon e mbaron prej 70 vjetësh programi i Gjuhës Shqipe pranë Radio-Vatikanit, që dërgon në eter mesazhin e Lajmit të Mirë, mesazhin e paqes e të drejtësisë, të vëllazërimit e të amshimit, ndërsa në sfond dëgjohen tingujt e himnit simbolik: "Krishti fitoi, Krishti sundon, Krishti do të mbretërojë"!

R.SH. - Vatikan

Ky 70-vjetori është një cak i bukur! Mbi dyzet vjet për të ndihmuar një popull dhe një Kishë të shtypur nga diktatura komuniste; tridhjetë vjet shërbimi për rindërtimin e vështirë civil e shoqëror, moral e fetar të këtij populli e të kësaj Kise.

Shqipëria, Kosova e të gjitha trevat shqiptare kanë qenë gjithnjë në zemrën dhe vëmendjen papëve, që kanë pasuar njëri-tjetrin në këto shtatëdhjetëvjeçarë, ne kemi dhënë dëshminë tonë përmes fjalëve të transmetuara ditë për ditë me mjetin e brishtë, por të fuqishëm, të valëve të radios, i vetmi që edhe regjimi më i ashpër nuk mundi ta bllokonte plotësisht.

Radioja e Vatikanit është shumë krenare që mundi ta bëjë këtë shërbim në vitet më të errëta të historisë së Shqipërisë, kur vendi që deklaruar zyrtarisht si i vetmi "shtet ateist" në botë. Por e njëjta Radio dëshiron të vijojë ta shoqërojë ecjen e shqiptarëve në këtë epokë të re, në të cilën e vetmja paqe në liri, paqja politike e brendshme e ndërkombëtare, paqja shoqërore e mbi të gjitha paqësimi i zemrave është ende detyrë që qëndron para nesh. E bëjmë këtë me impenjim krejt të posaçëm gjatë krizës së Kosovës, por dëshirojmë ta bëjmë çdo ditë, duke u frymëzuar nga mësimi i lartë i Papës, në bashkim të thellë shpirtëror me Kishën katolike të pranishme në viset e gjuhës shqipe e me të gjithë burrat e gratë veprimtarë e ndërtues të paqes.

Ishte shtatori i vitit 1951, 70 vjet më parë, kur Sekretaria e Shtetit të Qytetit të Vatikanit vendosi që Radioja e Papës të flasë edhe në gjuhën shqipe. Për ngritjen e programit të ri u thirr meshtari shqiptar në mërgim, Monsinjon Zef Shestani. Zëri i tij u dëgjua në valët e Radios së Papës më 3 tetor 1951, në orën 21, kur nisi transmetimi i parë i programit tonë, me temën simbolike: "Udhën e Kryqës". Populli shqiptar asokohe përshkonte udhën e vet të kryqit nën thundrën e diktaturës komuniste. Ishte një udhë kryqi e mundimshme, reale. Dëmet që i shkaktoi fesë së Krishtit ishin nga më të rëndat që mbahen mend në historinë e Kombit shqiptar.

Në kohën kur komunizmi bëri çmos të mbyllte çdo gojë që fliste në emër të Zotit, kur u rrokullisën kumbonët nga kumbonaret e heshtën uratët në Kishat e shkallmuara, zëri i Radio-Vatikanit vijonte të niste mesazhe përtej perdes së hekurt. U çonte shqiptarëve



mesazhet e Atit të Shenjtë, mesazhe ngushëllimi e durese, qëndrueshmërie e ngrohtësie vëllazërore, shprese e paqeje. Telat me gjemba që ndanin Shqipërinë nga bota, nuk mundën ta ndalojnë këtë zë të hynte fshehurazi, me kujdes, si një uratë e pëshpëritur pothuajse pa zë, por me gjithë shpirt, ndër shtëpitë e atyre që besonin e shpresonin në Zotin. Selia e Shenjtë nuk i kishte harruar bijtë e vet të masakruar! Bariu i mirë nuk e largonte për asnjë çast vështrimin nga grigja në gojë të ujkut.

Në periudhën e diktaturës komuniste në Shqipëri Radio Vatikanin në gjuhën shqipe u përpoq të zëvendësonte klerin e zhdukur, ta çonte zërin e Ungjillit në çdo shtëpi, t'i kthente shtëpitë në Kisha të vogla dhe prindërit, në barinj shpirtëror të fëmijëve të tyre. Për këtë flet qartë Rruzarja Shenjte, që thuhej çdo të shtunë para mikrofonit tonë nga Monsinjon Zef Shestani, Motër Luçie Lacaj me një grup murgeshash e laikësh dhe ndiqej pas telave me gjemba nga qindra besimtarë.

Monsinjon Zef Shestani, me përshpirtërinë e meshtarit dhe vetëmohimin e patriotit të flakët, përballoi vështirësitë e kohëve të para dhe vuri themelet e Programit të Gjuhës Shqipe. Më vonë thirri pranë si bashkëpunëtorë, Zef Palin, Andrea Shulin, motrën engjëlllore, Luçia Laca dhe, si bashkëpunëtorë të jashtëm, Atë Danjel Gjeçajn ofm.

Në fillimet e veta, Programi i Radio Vatikanit në gjuhën shqipe transmetonte tri herë në javë. Pastaj transmetimi u bë i përditshëm. Tematika fillestare ishte vetëm liturgjike-kishtare, por më vonë u pasurua, duke përfshirë dokumentet më të rëndësishme të Papës, veprimtaritë dhe shtegtimet e Atit Shenjtë, për të vijuar me veprimtaritë e Sëllisë së Shenjt dhe Kishës katolike

në trevat Shqiptare e në botë, çështjet e rëndësishme të etikës, të shoqërisë, të kulturës, letërsisë e artit, parë gjithnjë në këndvështrimin ungjillor.

Në fillim rrethi i bashkëpunëtorëve vijonte të ishte tepër i ngushtë. Radioja fliste. Po ishte një monolog i gjatë. Një monolog i dhimbshëm më se 40 vjeçar. Asnjë përgjigje nga dëgjuesit! Asnjë zë nuk pipërinte përtej telave me gjemba. Zërat shqiptarë të Radio - Vatikanit flisnin me dashuri, maturi, me kujdes të madh. Një fjalë e papeshuar, e përtej perdes së hekurt fillonte një valë e re martirizimi. Po, lavdi Zotit, erdhi dita e ëndërruar. Diktatura komunist u shemb dhe filloi bashkëbisedimi ynë me dëgjuesit, që gjithnjë më shpesh janë edhe mysafirë në programet tona.

Nga themelimi, 3 tetor 1951 e deri në vitin 1988 redaksinë në gjuhën shqipe të Radio Vatikanit e drejtoi Monsinjon Zef Shestani. Pas këtij u drejtua nga Gjon Gjomarkajt, i cili vijoi deri në daljen e tij në pension, në vitin 1992. Që nga kjo kohë, redaksia e gjuhës shqipe pranë Radio-Vatikanit Vatican-News drejtohet nga meshtari don David Gjuga. Në redaksi punojnë Ana Luka, Katerina Nushi dhe Klaudia Bumçi.

Nuk mund të mos kujtojmë në këtë jubile edhe kolegët e tjerë, që u ulën para mikrofonit tonë në periudha të ndryshme: bashkëpunëtorët e brendshëm, Franc Pali, Engjëll Koliqi, Ines Angjeli Murzaku, Arben Marku e shumë të tjerë. Nuk mund të mos i kujtojmë edhe bashkëpunëtorët e jashtëm, tejet të çmueshëm, që sjellin në programin tonë freskinë e ngjarjeve në trevat shqiptare.

Emrat e tyre janë të njohur nga dëgjuesit e lexuesit tanë: nga kryedioqëzi Metropolit i Shkodrës filluan të na flasin Pal Tedeskini e Gjovalin Stefa; vijoi bashkëpunimin Jolanda Baba. Nga kryedioqëza e Tiranë-Durrësit filluam bashkëpunimin me Ferdinand Samarxhiun, Mira Tucin, Ferdinand Ndoci; me gazetarët e Tiranës- Aurela Nomani e Rezart Xhaxhiu - të gjithë kryesisht kumtues të ngjarjeve nga kryeqyteti; ndërsa lidhjen me Durrësin e filluam me Entela Gjellucin, për ta vijuar deri më sot me Matish Gjellucin. Nga Elbasani filloi të na flasë për herë të parë Esmeralda Çekrezi, e cila që nga dhjetori i 1998-tës u zëvendësua nga Gjulia Lurthi e tani nga Mariza Stratti. Me jetën dhe veprimtarinë e Kishës katolike në Vlorë nisi të na njihte Gjon Meshi, që më pas e ndërpreu bashkëpunimin.

Radio Vatikan i përket gjithë shqiptarëve, kudo që të jenë, nga Shqipëria në Kosovë, nga Arbëreshët e Italisë, tek ata të Greqisë; nga Evropa, në Amerikë e kudo gjetkë, ku flitet shqip e ku njerëzit kanë dëshirë ta dëgjojnë mesazhin e Krishtit e të papës në gjuhën amtare. Prandej para mikrofonit tonë flasin vazhdimisht edhe bashkëpunëtorët nga Kosova, Rabije Ibraj, Lekë Musolli, Zef Komani, Afrim Gjonbalaj, Augustin Paloka; nga Mali i Zi - motra Olga Dulaj; nga arbëreshët e Italisë, Alfredo Frega e Zef Chiaromonte; nga Shqiptarët e Amerikës, zëra të ndryshme që ndjekin kronikat e festave; po kështu edhe nga kishat e tjera të mërgimit, në të cilat shqiptarët katolikë nuk harrojnë të mbledhen ndër ditë të mëdha për t'ia drejtuar Zotit uratën



në gjuhën shqipe.

Kemi tashmë edhe një arkiv shumë të pasur, ku në radhë të parë ruhet zëri i Papës sa herë flet për Shqipërinë dhe shqiptarët. Natyrisht ruajmë të gjitha fjalimet e Gjon Palit II mbajtur gjatë vizitës së tij historike në Shqipëri më 25 prill 1993 e tani, zërin e Benediktit XVI dhe të Françeskut. Ruajmë edhe zërat e shumicës së klerikëve shqiptarë, duke filluar nga katër ipeshkvijtë e parë të pas diktaturës: Imzot Frano Illia, Imzot Rrok Mirdita, Imzot Robert Ashta, Imzot Zef Simoni - e duke vijuar me ipeshkvijtë e rinj që u vunë në krye të dioqezave e të administraturave apostolike si: Imzot George Frendo, Imzot Angelo Massafra, Imzot Simon Kulli, Imzot Gjerg Meta, imzot Giovanni Peragine, imzot Rrok Gjonlleshaj, imzot Dode Gjergji. Vijnë pastaj meshtarët e ipeshkvij aktivë, si don Lush Gjergji; don Henri Welkamp, don Marian Paloka, don Dritan Ndoci, don Domenik Qerimi pa kujtuar misionarët e shumtë, e deri tek meshtarët e parë shqiptarë të mijëvjeçarit të tretë. E jo më pak - murgeshat: motër Lidia Kçira, motër Elena, motër Teuta Buka, Motër Vitalba Motoleze e shumë të tjera.

E tashmë kemi krijuar edhe një fond mjaft të pasur me zërat e presidentëve, kryeministrave, ministrave, politikanëve, njerëzve të kulturës e të artit nga Shqipëria, Kosova e nga gjithë diaspora shqiptare. Natyrisht ruajmë të plota regjistrimet e audiencave të ambasadorëve të Republikës së Shqipërisë për paraqitjen e letrave

kredenciale në Vatikan, që 22 prilli 1993, kur ambasadori i parë i Shqipërisë pranë Selisë së Shenjtë, shkëlqesia e Tij Willy Kamsi i paraqiti letrat kredenciale Papës Gjon Pali II e deri më 29 shtator 2006, kur ambasadori i fundit, shkëlqesia e tij, zoti Rrok Logu i paraqiti Benediktit XVI letrat kredenciale në Kastel Gandolfo.

Shfletojmë arkivin për një kronologji të shkurtër të ngjarjeve më të mëdha kishtare, ndjekur hap pas hapi nga mikrofonin ynë:

1989 - vizita e parë e Nënë Terezës në Shqipëri; 1990 kremtimi Meshëve të para të pas diktaturës në Shkodër (Nga Don Simon Jubani) e në Tiranë (Nga Atë Zef Pllumbi);

1991 - vizita e delegacionit të parë të Selisë së Shenjtë në Shqipëri. Rivendosja e marrëdhënieve diplomatike në rang nunciature apostolike për Selinë e Shenjtë dhe ambasade për Shqipërinë;

1993 - Ambasadori i parë Willy Kamsi paraqet letrat kredenciale pak ditë para shtegimit të Papës Gjon Pali II drejt Shqipërisë;

1993 Rihapet seminari papnor në Shkodër; 25 prill 1993 - Papa Gjon Pali II viziton Shkodrën dhe Tiranën: gjatë vizitës i dhuroi Kishës së martirizuar hierarkinë e re të pasdiktaturës.

1994 - Ati i Shenjtë krijon kardinalin e parë shqiptar, Hirësinë e tij, Mikel Koliqin....

2001 - vizita "ad Limina" e ipeshkvijve të Shqipërisë (2 deri më 4 shkurt 2001) dhe të Kosovës në Vatikan....

... Sa shumë ngjarje, porosi mesazhe: ndërmjet tyre - mesazhi i Papës Gjon Pali II drejtuar popullit shqiptar nga katedralja e Shkodrës në ditën e paharruar të 25 prillit: "Kjo është dita e falur prej Zotit, ditë gëzimi, e ipeshkvi i Romës erdhi ta kremtojë së bashku me ju. Ipeshkvi i Romës për shumë vjet është lutur për ju, së bashku me gjithë Kishën.... E sot Pasardhësi i Shën Pjetrit... përsërit para Jush, që jeni mbledhur këtu, para Shqipërisë, Evropës, para Kishës universale e para mbarë botës: "Përvoja juaj e vdekjes dhe e ringjalljes i përket gjithë Kishës dhe gjithë botës. Çdo njeri duhet të reflektojë rishtas mbi gjithçka lidhet me Jezusin, që u dënua me vdekje dhe u kryqëzua dymijë vjet më parë. Duhet të reflektojë edhe mbi çka ju ngjau ju gjatë disa dhjetvjeçarëve të shekullit XX! Është e drejtë të shikosh përpara për të rindërtuar një ardhmëri të lirë, me fytyrë njerëzore, por përvoja e kaluar nuk duhet harruar, për të shmangur përsëritjen e të njëjtave gabime të një periudhe shumë të mjerueshme... të paparë në rrjedhën e historisë... Nuk duhet harruar ç'ka ngjarë... nuk duhet harruar!"

Po të kthehemi përsëri tek zërat tjerë të kronikës sonë: Kardinali i parë shqiptar Mikel Koliqi na ka lënë trashëgim me zërin e tij shumë mesazhe e porosi për t'i qëndruar besnikë Krishtit e Papës. Më 21 shtator 2014 vizita e Papës Françesku në Tiranë, vizita e

parë e Papës Bergoglio në Evropë. Krijimi i kardinalit të dytë në personin e dom Ernest Simoni Troshani, emërimet e ipeshkvijve etj. etj. Ruajmë disa regjistrime me zërin e së Lumes Nënë Terezë dhe gjithë kremtimin e Lumnimit të saj në Vatikan më 19 tetor 2003.

Zëri i parë me përmbajtje fetare e shpirtërore, ndërmjet dhjetëra radios që flasin shqip, ndjek me vëmendje, shqetësim e kujdes ngjarjet e reja që sjell çdo ditë, duke u gëzuar e duke u shqetësuar me popullin shqiptar.

Po kështu ndoqëm ngjarjen aq të dëshiruar e të pritur të shembjes së komunizmit - por edhe ngjarjet e padëshiruara të 1997-tës me pasojat e tyre shkatërrimtare; po kështu ndoqëm tragjedinë e popullit kosovar, duke hapur një program të veçantë në gjuhën shqipe e italiane, titulluar "Speciale Balcani", që nisi të transmetohej më 25 maj 1999, qysh në fillimet e tragjedisë kosovare, e përfundoi fatbardhësisht në sa binte perdja e kësaj tragjedie, më 30 tetor 1999; ndërsa vijon të lidhet ngushtë me shqetësimet e pas-luftës në Kosovë e deri te shpallja e Pavarësisë së saj si Shtet i Pavarur dhe Sovranë më 17 shkurt 2008. Pastaj me çështjen e shqiptarëve në vise tjera, pa e larguar kurrë vëmendjen nga mijëra shqiptarë që tashmë janë përhapur në të katër anët e botës.

Ju flet Radio-Vatikani në Gjuhën Shqipe! Ju uron paqe e të mira! Nuk është më një monolog i gjatë. Të dashur dëgjues, dëshirojmë të bashkëbisedojmë me ju, t'u përgjigjemi dëshirave tuaja, prandaj na shkruani, na telefononi... që kështu të bashkojmë zërat në shërbim të një ideali tepër të lartë: Ungjillëzimit të ri të popullit shqiptar, ndërtimit të qytetërimit të dashurisë në Shqipërinë e re.

Laudetur Iesus Christus - duke lavdëruar Jezu Krishtin fillon e mbaron prej 70 vjetësh programi i gjuhës ghupe pranë Radio-Vatikanit - Vatican News, që dërgon në eter mesazhin e Lajmit të Mirë, mesazhin e paqes e të drejtësisë, të pajtimit e të amshimit, ndërsa në sfond dëgjohen tingujt e himnit simbolik: "Krishti fitoi, Krishti sundon, Krishti do të mbretërojë!"



DIAKONI ËSHTË NJERIU QË E IDENTIFIKON VETEN ME KRISHTIN SHËRBËTOR

*Shugurimi diakonal i Atë Rrok Shporaj, CM
Diakoni: ikona e Krishtit shërbëtor*

Të Shtunën, 21 Shtator 2021, në Katedralen "Shën Shtjefni" të Shkodrës, u kremtua mesha e shenjtë me ritin e shugurimit diakonal të studentit tonë akolit Rrok Shporaj, vinçencian, me origjinë nga fshati Shporë (Mazrrek), por që u shpërngul në vitet 2007 në Grudën e Re.

Meshën dhe vendosjen e duarve mbi diakonin e ri e udhëheqi Arqipeshkëvi i Shkodër-Pult, Mons. Angelo Massafra, ofm. Morën pjesë jo vetëm bashkëvëllezërit shqiptarë, por edhe Ati Provinçjal, p. Erminio Antonello, p. Roberto Iovera, p. Nicola Albanesi, si shenjë e bashkimit e të gjithë Provincës Italiane me Krahinën e Shqipërisë.

Ishte një moment emocionues për të gjithë: para së gjithash për Rrokun, pastaj për të gjithë komunitetin vinçencian dhe familjen e diakonit të ri. E shumtë ishte edhe pjesëmarrja e besimtarëve: në veçanti nga Gruda e Re, Vinoteka dhe Hoti i Ri. Një përfaqësim i mirë erdhi edhe nga zona misionare e Fushë-Mamurras, Adriatik.

Si student vinçencian, Rroku ka njohur shumë grupe të rinjsh nga RMV (Rinija Mariane Vinçenciane) me të cilët animoi kampet e shërbimit në Shkodër. As këta të fundit nuk munguan: erdhën të rinjë nga Kosova (Zllakuqan), nga Durrësi, nga Gramshi, nga Rresheni, nga Tirana.

Në predikimin e tij, ipeshkëvi theksoi se si diakoni është njeriu që e identifikon veten me Krishtin shërbëtor: shërbëtor i Fjalës, i bamirësisë dhe i



Eukaristisë. E gjithë kjo merr një vlerë edhe më të thellë dhe më specifike nëse shihet në dritën e karizmës së Shën Vinçenc de Paulit. Krishti që ne misionarët ndjekim në vizionin vinçencian është Krishti "Ungjillëzuesi dhe Shërbëtori i të varfërve", prifti i Atit, i cili u mishërua për t'u sjellë lajmin e mirë të Mbretërisë të varfërve. "Sekreti i këtij identifikimi me të është bashkimi intim me Krishtin në lutje", kujtoi ipeshkëvi Massafra. Atë Rroku është thirrur edhe një herë nga Kushtetutat e Kongregatës së Misionit për tu "veshur në Krishtin, duke i bërë mendimet dhe ndjenjat e tij".

Në fund të kretimit Eukaristik, si Ati Provincial ashtu edhe Atë Rroku falënderuan Ipeshkëvin dhe të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre.

Rroku kërkoi të lutej për të, për besnikërinë e tij në udhëtimin e tij thirrës. Së fundi, ai tregoi se si gjatë gjithë këtyre viteve është ndier i shoqëruar nga prania e Marisë, Zojë së Këshillit të Mirë, nën titullin "Zoja e Shkodrës".

Festa vazhdoi më pas në oratorin e Grudës së Re me këngë dhe valle tradicionale, një shenjë e një komuniteti në festë. Po në të njëjtin ambient, në dark, familja vinçenciane dhe familja e Atë Rrokut të ardhur nga Italia dhe Greqia, bashkëndanë këtë gëzim me miq, laikë dhe bashkëpunëtorë të zonave baritore ku Etërit vinçencianë punojnë.

Unë do të doja të përfundoja me një rekomandim të dhënë nga ipeshkëvi Massafra si dhe nga Atë Rroku: angazhimi, dhe përgjegjësia që na takon të gjithëve neve - laikë, të përkushtuar dhe jo - për t'u lutur për thirrje të reja, për të krijuar një kulturë thirrëse, një terren të favorshëm për krijimin e një mentaliteti thirrës, në përgjigje të Zotit për të gjitha thirrjet.

Zoti e bekoftë Kishën e vet me thirrje të shenjta.

Atë Luigi Cannato, CM



KUSHTET E PËRJETSHME TË MOTËR EMILJANA JAKUT

Shkodër 8 Shtator 2021

Në dioqezën Shkodër-Pult dhe për Kishën mbarë ishte një gëzim i madh, sepse motër Emiljana Jaku, juniore e Motrave Salvatoriane i është kushtuar Zotit përjetësisht me kushtet e saja Rregulltare, duke dëshmuar kështu qartë se do ta jetojë jetën e vet sipas Këshillave Ungjillore: në Pastërti, Varfëri e Bindje. Kushtimin e saj e bëri në Kishën "Zoja Rruzare" Kosmaç, vendi ku motra është rritur. Mesha e Shejtë u udhëhoq nga Shkëlqesia e Tij Imzot Angelo Masaffra dhe me praninë e shumë meshtarëve dhe besimtarëve: familiar, miq dhe të ftuar të motër Emiljanës e cila po i kishte Zotit. Kremtimi Eukaristik dhe riti i kushtimit ishin zemra e asaj dite. Monsinjori në homelinë e Tij shpjegoi domethënien kushteve dhe bukurinë e Jetës së Kushtuar, ku dhe porositi familjet që të edukojnë fëmijët dhe të rinjtë në fe, sepse vendi ynë ka nevojë për thirrje të reja meshtarake dhe rregulltare. Pastaj, pas predikimit ishte momenti ku motër Emiljana



bëri kushtimin e saj të përjetshëm në praninë e Eprores Provinciale, motër Mimoza Jaku, duke u bërë kështu pjesë për tërë jetën në familjen Salvatoriane. Me anë të këtij momenti, motra ka shprehur me gëzim dhe liri të plotë gatishmërinë e kushtimit të saj Zotit. Duke falenderuar Zotin për thirrjen e motër Emiljanës dhe për përgjigjen e saj dhënë Zotit, vazhdojmë të lutemi përsëri për thirrje të reja dhe të shenjta, sepse Kisha ka nevojë për njerëz që dëshmojnë Zotin dhe që janë të gatshëm t'i përgjigjen PO sikurse Maria i është përgjigjur vullnetit të Zotit me një Po përgjithmonë.

Motrat Salvatoriane

FESTA E VARRËVE TË SHËN FRANÇESKUT TË ASIZIT

Jeta e çdo njeriu, duke përfshirë këtu edhe atë të shenjtërve, përbëhet nga disa momente të veçanta, të cilat lënë një vulë të pashlyeshme te ne. Ato shërbejnë si pikë referimi për të folur rreth figurës së një personi në tërësinë e tij. Një moment i tillë në jetën e Shën Françeskut të Asizit është pa diskutim marrja e varrëve të shenjtë të Jezu Krishtit. Ai që i pari në historinë e krishterimit që i përngjau Krishtit aq shumë, sa që përjetoi edhe dhimbjet e varrëve të tij, një gjë kjo kontradiktore pasi njëkohësisht me dhimbjen fizike ai përjetonte edhe ëmbëlsinë e dashurisë së Krishtit.

Familja françeskane, në veçanti Motrat Stigmatine, e kremtojnë festën e Stigmatizimit të Shën Françeskut më 17 shtator 2021. Me këtë rast Motrat Stigmatine në Shkodër kanë kremtuar vigjiljen dhe meshën e shenjtë në kishën e Shën Bonaventurës. Vigjilja është kremtuar me datën 16 shtator 2021 në orën 17:30 dhe ka qenë e përbërë nga dy momente kryesore.

Në fillim është bërë adhurimi i të Shenjtë-rueshmit Sakrament nga ora 17:30 deri në orën 18:30, ndërsa në pjesën e dytë është lutur Mbrëmësorja, e cila është udhëhequr nga provinciali i Provincës françeskane shqiptare “Zoja Nunciatë” fra Pashko Goçaj. Ai pas Leximit të shkurtër ka bërë një reflektim të shkurtër rreth kësaj feste duke e lidhur edhe me historinë që ka kaluar vendi ynë në periudha të ndryshme, sidomos gjatë periudhës së komunizmit, dëshmitare të gjalla të së cilës janë edhe dy motrat Stigmatine motër Roza Kraja dhe motër Maria Kaleta. Sigurisht që nuk mund të lihej pa përmendur edhe figura e të lumes Marie Tuci, e cila edhe ajo dëshmitare e kësaj



periudhe, u bë shembull qëndrueshmërie për të gjithë ne. Që prej ardhjes së tyre në Shqipëri motrat Stigmatine kanë dhënë një kontribut shumë të madh në fushën shpirtërore, edukuese, arsimore, kulturore etj., duke lënë kështu një vulë të pashlyeshme. Në lutje u bashkuan besimtarë, motra të kongregatave të ndryshme dhe ndjekës të tjerë të Shën Françeskut.

Ndërsa me datën 17 shtator u kremtuar mesha e shenjtë nga fra Pashku në orën 17:00. Bashkëkremtues ishin etërit kapuçinë dhe zëvendës provinciali fra Aurel Gjerka. Gjatë predikimit fra Pashku përshkroi shkurtimisht momentin kur Ati serafik mori varrët e shenjtë të Jezu Krishtit në malin La Verna në vitin 1224, duke e quajtur këtë moment si kthimi i dytë i Françeskut. Një ndër pyetjet që mund të shtrohet është “Cila ishte zanafilla e marrjes së varrëve të shenjtë?”. Përgjigjja e kësaj pyetjeje gjendet në brendësinë e Atit serafik, i cili kërkoi nga Hyji i Gjithëpushtetshëm të përjetonte dhimbjen e mundimeve dhe dashurinë e ëmbël të Krishtit. Ndërsa përgjigjja e Hyjit për kërkesën e tij ishte pikërisht dhurimi i varrëve të shenjtë të Jezu Krishtit.

Para bekimit përfundimtar delegatja e motrave Stigmatine në Shqipëri motër Terezina Demaj falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre, sidomos fra Pashkun për udhëheqjen e këtyre momenteve të veçanta, si dhe korin me dirigjent Fatjon Tanazin dhe Rozeta Leka në piano, të cilët kanë ndihmuar për ta përjetuar më mirë liturgjinë e kësaj feste.

Fra Lorenc Pepniku
Shkodër, 17 shtator 2021



KOLEC ÇEFA: NJË PENDË SHQIPTARE QË DO I MUNGON SHKODRËS (Shkodër 1937 – Tiranë 2021)

Një “requiem” me rastin e kalimit në amshim të studiuesit të palodhur të kulturës shqiptar

Intelektuali solid Kolec Çefa, me kulturën e thellë dhe të gjërë që zotëronte nga përvoja dhe leximet e librave të shumtë, ishte një enciklopedi e gjallë, që ecte me dy këmbë, duke mbajtur të freskët në mendje çdo ngjarje dhe figurë të qytetit tonë. Më 22 gusht u kthye përgjithmonë nga Tirana, në Shkodër në shtëpinë e përrjetshme në varret e Rremajt.



Koleci (më emrin e pagëzimit Nikollaus) u lind në Shkodër më 26 shkurt 1937 nga baba Shtjefen Matia e nëna Roza Tomë Shiroka që banonin në lagjen Arra e Madhe. U pagëzua një ditë pas lindjes (27) nga dom Zef Shestani, më nuna: Ndue Paci dhe Luce Ndre Rashi. Koleci kishte tre vëllezër e dy motra të cilët të gjithë ishin të arsimuar dhe punonin në arsimimin e brezave të rinj. Vëllai i madh Matishi, për shkak të mospajtit me diktaturën komuniste qëndroi për disa vite në burgjet e Enver Hoxhës.

Koleci, shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Shkodër dhe në vitin 1954 emërohet mësues në Pukë për afro 10 vite. Nga dëshira e madhe për studime të mëtejshme, ai kreu Institutin 2-vjeçar në Shkodër me korrespondencë si dhe me vonë atë 4 vjeçare në Tiranë, për gjuhë e letërsi, prape me korrespondencë. Edhe pse tregoj një talent të veçantë në fushën e gjuhës e letërsisë shqiptare, për shkak të burgosjes së vëllait, nuk u lejua të punonte në qytet dhe të përparonte në studime të mëtejme, por gjithë jetën e kaloj, si mësues në Mal Kolaj dhe Dajç të bregut të Bunës. Dy vite para se të përmbylej drama shqiptare me rënien e komunizmit, Koleci pati mundësinë për tu rikthyer si arsimtar duke punuar në Shkodër.

Me instalimin e pluralizmit politik në Shqipëri dhe lirisë së mirëfilltë fetare në vitin 1991, Koleci e pa të udhës të jetë pranë Dom Zef Simonit, si person i mirëbrumosur në gjuhë e letërsi dhe i lidhur si fëmijë me klerin katolik nga i cili edhe pse në

heshtje asnjëherë nuk qe shkëputur as në vitet e zeza të persekutimit të tyre.

Puna e gjatë përkrah imzot Zef Simonit, si sekretar i tij në argjipeshkvinë e Shkodrës nga viti 1993 - 2009 i krijoi mundësitë të shfletonte e të studionte dokumente të panjohura, të shpëtuar prej arkivave kishtarë. Luajti një rol të dorës së parë, në botimin mujor të revistës dioqezane “Kumbona e se Dielës” në rolin e kryeredaktorit nga rifillimi i botimit, korrik 1992 e deri në janar-shkurt 2004, kur kjo revistë fetare e kulturore e themeluar nga Dom Mikel Koliqi në vitin 1938, kishte kaluar në dorë të redaktorit të tanishëm dom Nikë Ukgjinit.

Botimin e librit “Martirizimi i Kishës Katolike,



1944-1990”, Shkodër, 1993, ku përfshihet edhe portreti i dom Ndre Zadejës, fryt i pendës së tij. Mori në dorë, si redaktor dhe autor i një pjesë të mirë të veprave të meshtarëve, botuar gjatë këtyre viteve. Posaçërisht, veprat e atë Donat Kurtit. Gjergj Fishtes, Gasper Gurakuqit, Luigj Gurakuqit, Familjen Sumaj, Monografi për Justin Rroten, etj.. Për tu veçuar janë: libri i titulluar “Nëpër gjurmët e Fishtës”(Shtëpia Botuese Françeskane, Shkodër, 2003), vepra për Luigj Gurakuqin, titulluar “Luigj Gurakuqi në një optikë të re”, etj.. Me fanatizëm ruante dorëshkrimet e Kurtit, Rrotës, Fishtës,, Zadejës, Shantojës, Valenitint, Volajt etj..

Shkrimet e tjera, që mbetën të përhapura në revista e gazeta, mund të përmbledhen në një libër shumëfaqësh. Me botimet e shumta kushtuar

kryeveprave të klerit katolik, u bë sakaq penda më e njohur në lëmin e studimit të autorëve të ndaluar gjatë 50- vjetëve të regjimit komunist. Nuk ia përtoi të hyjë edhe në polemika, ndërsa vijon sulmi kundër trashëgimisë së tyre letrare.

Që të mos harrohet kurrë kontributi i tij dhënë Kishës Katolike e asaj kulture për të cilën krenohet Shkodra, ku penda të reja të talentuara ecin në gjurmët e pashlyera të paraardhësve!

Ruaj kujtime shumë të bukura, mbasi kemi punuar bashkë për shumë vite, në Arqipeshkvinë e Shkodrës. Koleci ishte i urtë, i ditur, i mençur me shpirt të madh fisniku. I ndihmonte këdo që i shkonte në redaksi për dokumente, literaturë (libra), saktësimin e datave dhe ngjarjeve të ndryshme, rreth figurave të shquara të Klerit Katolik Shqiptar dhe të letërsisë shqiptare, buletinet e ndryshme të shtypit katolik të hershme dhe deri në ditët tona.

Tashti që Koleci fle në paqe në Rrëmaj, për të flet vepra e tij, që e kemi të gjallë mes nesh!

Dom Nikë Ukgjini



+++++



**KURIA KRYDIOQEZANE
SHKODËR-PULT**

Shkodër, 22/08/2021

*Të nderuar familjarë të ndjerit Kolec Çefa
Zoti ju dhashtë paqe!*

Duke qenë se nuk mund të jem i pranishëm në salikimin e zotit Kolec, nëpërmjet këtij mesazhi, të cilit ja kam dorëzuar Famullitarit, Don Vlash Palaj, qe e falënderoj, Ju shpreh ngushëllimet e mija të sinqerta .

Zotin Kolec e kujtojmë për kontributin e madh të dhënë për mbrojtjen e parimeve të Krishtera në aspektin historik e letrarë dhe për kontributin si Kryerdaktor i Rivistes “Kumbona e se Dieles”.

Gjithashtu e kujtoj dhe e falënderoj për punën e bërë në Kurien Dioqezane të Shkodrës pas stuhisë së diktaturës komuniste, si sekretari i paraardhësit tim, të ndjerit Arqipeshkëvit të Shkodrës Imzot Frano Illija.

Ju siguroj lutjen time për shpirtin e të ndjerit Kolec: Krishti e pastë në Parriz dhe juve familjare ju dhashtë kivet.

**+ Angelo Massafra OFM
Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult**

SFIDAT DHE PROBLEMATIKAT E TË RINJVE

Arqipeshkëvi i Shkodrës bashkë me seminaristët në Razëm

“Është më së i drejtë dhe i merituar pushimi, pasi që të jetë përmbushur detyra.” (P. Pio)

Razëm, 30 qershor 2021

Edhe këtë vit, siç çdo vit tashmë, Arqipeshkëvi ynë Mons. Angelo, na ka dhënë mundësinë që të kalojmë disa ditë me të në Shtëpinë e pushimit të dioqezës sonë në Razëm, e pikërisht nga datat 30 qershor deri me 02 korrik 2021. Ishim të pranishëm bashkë me Ipeshkvin, ne seminaristët e Shkodrës. Qëllimi i këtyre ditëve është i dyfishtë: qëllim verifikimi i vitit dhe formimi, bashkëndarje atërore me Ipeshkvin. Nga ana tjetër edhe kohë vëllazërie pushimi e çlodhje vëllazërore.

jeton”. Më pas ishte dreka, pastaj pushimi ose kohë e lirë dhe pastaj ishte mundësia e takimit personal me Arqipeshkvin. Në pasdite ishte momenti i takimeve personale me Ipeshkvin. Ky moment ishte i një rëndësie të veçantë për ne seminaristët, sepse kishim mundësinë të takonim Ipeshkvin tonë dhe para se të verifikonim vitin shkollorë, lodhjen etj., kishim mundësinë të provonim edhe bukurinë e takimit atërore të Ipeshkvit i cili është treguar mirëkuptues, dhe inkurajues për ecjen tonë. Vlen të përmendet dashuria pranuese e tij, guximi për të ecur përpara, afërsia e tij atërore dhe dëshira e tij për



Gjatë këtyre ditëve Arqipeshkvi na nxiti që secili të lexonte, të përgatiste dhe të thellonte një pjesë të Nxitjes Apostolike “Krishti Jeton” (Christus vivit), të Papa Françeskut. Ka qenë shumë interesante bashkëndarja mes nesh e rëndësisë së veçantë që përmban ky dokument, në lidhje me sfidat dhe problematikat e të rinjve si dhe qëllimit të jetës dhe dhuratës së thirrjes. Secili prej nesh përgatiste dhe thellonte disa numra dhe kishte mundësinë t’i bashkëndante në prani të Arqipeshkvit, i cili pastaj na ndihmonte që të mos harrojmë se jemi të rinjtë dhe se kemi për detyrë që të jemi shembull edhe për ata të rinjtë që takojmë, duke ju përçarur kështu bukurinë e jetës me Zotin.

Dita fillonte si gjithmonë me lutjen e mëngjesit, pastaj kishim mëngjesin dhe fill pastaj shoqëroheshim me Nxitjen Apostolike “Krishti

një kishë të re edhe me kontributin dhe shembullin tonë.

Në mbrëmje kishim meshën e shenjtë në Kapelën e shtëpisë ku ishe e hapur edhe për besimtarët pushues në Razëm. Pas meshës vinte darka vëllazërore dhe fill pas shërbimet dhe momentet argëtuese mes nesh.

Për ne që vinin pas një përvoje të fortë provimesh në seminar, ato ditë përveç freskisë që të ofron Razma, patëm mundësinë e një freskie edhe shpirtërore e vëllazërore me njëri-tjetrin dhe me Arqipeshkvin. Falënderojmë Zotin për të mirën që i bën Kishës së vet dhe e lusim që të mos mungojnë thirrjet e shenjta në meshtari.

Fation Mullarthy
Viti VI Teologji

VARRET PO SHKATËRROJNË MONUMENTËT E KULTURES NË LEZHË

*Lezhë, varret e fshatit mbi rrënojat e kishave të shpallura monument kulture,
Dom Nikë Ukgjini: Po dëmtohet arkeologjia*



Varret e vendosura pa kriter po bëhen pengesë për zbatimin e projektit të rikualifikimit të vendit ku është mbajtur Kuvendi i Arbërit në Mërq të Lezhës, një nga ngjarjet më të rëndësishme pas Besëlidhjes së Lezhës i mbajtur 400 vite më parë. Studiuesi Dom Nikë Ukgjini i cili në bashkëpunim me Dioqezën e Lezhës dhe Bashkinë është iniciator i realizimit të këtij investimi, shprehet se varret po shkatërrojnë dhe arkeologjinë e këtij vendi vlera historike.

“Kemi hartuar projektin, duke menduar të bëhet diçka në kuvendin e arbit, pasi është koha që duhet ndërmarrë dhe të behet një përkujtimore për këtë ngjarje mjaft të rëndësishme dhe do të fillohet të realizohet. Gjatë kësaj periudhe që ekipi i punës ka bërë projektin varret vend e pa vend bëhen pengesë për realizimin e veprës sepse mendohet të lidhet kisha me qelën 400-vjeçare ku është mbajtur kuvendi i arbit ku do të ringrihet do të jetë vend

shtegtimi. Mendoj se është një problem shumë i madh, pasi vijohet të vendosen varre dhe po dëmtohet arkeologjia e këtij vendi historik” thotë Ukgjini

Situatë e ngjashme paraqitet edhe në objektet e





tjera të kultit monument kulture në zonën e Lezhës. Varret e vendosura pa asnjë lloj rregulli po shkatërrojnë historinë thotë studiuesi Dom Nikë Ukgjini dhe për këtë fajëson institucionet përgjegjëse.

“Është një fenomen që ka filluar prej shumë kohësh por sidomos kohët e fundit që po merremi me monumente të vjetra të shpallura monument kulture dhe atyre historike e kemi evidentuar më shumë. Janë bërë varre në themelet e kishave të vjetra monument kulture dhe kjo po shkatërrohet historinë sepse nën toka është pasur dhe do vijë një ditë që mund të bëhen gërmime arkeologjike. Njerëzit nuk kanë kontroll nuk ka një planimetri nga kisha dhe institucionet shtetërore që kanë për detyrë caktimin e varrezës publike, ndaj ndodh diçka e tillë. Situatë e ngjashme është në të gjitha kishat monument kulture dhe diçka e tillë me duket e pafalshme” shton Ukgjini

Vetëm gjatë muajve të fundit ngjitur me kishën mesjetarë të Shën Barbullës në Pllanë të Lezhës e cila është restauruar një vit më parë janë vendosur tre varre. Kujdestari vullnetar i këtij objekti kulti thotë se është i pafuqishëm të ndalojë diçka të tillë.

“Unë kujdesshëm në mënyrë vullnetare për Kishën që kur është restauruar. Kohët e fundit janë vendosur dhe tre varre ngjitur me muret e Kishës. Unë jam i pafuqishëm që të ndaloj diçka të tillë. Duhet ndërhyrja e autoritëve që të vendoset një planimetri me qëllim që mos të lejohen varreza aty” thotë Lazer Vokrii kujdestar i kishës

Me mjaft shqetësim e sheh këtë situatë dhe Kreu i Forumit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, historiani Pal Trashaj. Ai fajëson institucionet shtetërore për këtë masakër që po i

bëhet historisë së kishave monument kulture në Lezhë.

“Është një problem shumë serioz që vijon prej shumë vitesh. Janë bërë varre pa kriter në themelet e kishave të cilat kanë vlera të jashtëzakonshme historike. Në këtë mënyrë po shkatërrohet arkeologjia. Me ligj është e përcaktuar që nuk mund të bësh asnjë veprim brenda rrethimit të këtyre objekteve, por këtu nuk pyet kush për ligjin. Janë vetë institucionet përgjegjëse që kanë lejuar diçka të tillë dhe kjo është e pafalshme. Themelet e objekteve të kultit janë mbushur me varre, duke dëmtuar historinë e tyre” thotë Trashaj

E pyetur zyrtarisht për këtë çështje Bashkia e Lezhës thotë se po punohet për gjetjen e një zgjidhje që ti hapet rrugë zbatimit të projektit për kuvendin e Arbrit në Mërq të Lezhës.

“Po punojmë për të gjetur një zgjidhje për ti hapur rrugë zbatimit të projektit ku është mbajtur Kuvendi i Arbrit, për të cilin janë bërë pengesë varret. Gjithashtu do të shohim me përparësi situatën edhe në objektet e tjera të kultit ku ka probleme të kësaj natyre” thotë në përgjigjen e saj Bashkia Lezhë.

Në territorin e Bashkisë së Lezhës janë një numër i konsiderueshëm kishash të vjetra të shpallura monument kulture që mbartin vlera të jashtëzakonshme historike. Dy prej tyre janë restauruar vitet e fundit falë donacioneve private, por nevojat për ndërhyrje janë të shumta dhe në objekte të tjera të cilat rrezikojnë seriozisht rezistencën e tyre.

**Elvis Hila: gazeta, Panorama (Tiranë),
26. shtator 2021.**



KATEDRALJA E SHKODRËS NË ROLIN E FAMULLISË, EMËRTOHET “ZOJA E SHKODRËS”



Shkodër, 18 tetor 2021

Famullia e Shkodrës, me rastin e festës “Zoja e Shkodrës”, organizojë programin festive fetare treditor si nevojë e një përgatitje shpirtërore sa më të mirë në nderim të Zojës së Bekuar.

Festa e Zojës, kremtohet si momenti i largimit të figurës së Zojës së Këshillit të Mirë, nga Shenjtërorja rrëzë kalas Rozafat, me 25 prill të vitit 1467 për në Xhenecano për të shpëtuar nga dëmtimi i hordhive osmane që kishin pushtuar vendin tonë.

Fillim java e tret e muajt tetor, dita e hënë, konsiderohet momenti kur figura e Zojës, kishte arritur në Shenjtëroren e fretërve augustinian në kuvendin e tyre në Xhenecano në Itali.

Famullitari i kishës së Shën Shtjefnit të Shkodrës, dom Vlash Palaj, në shenjë nderimi ndaj kësaj date historike, me 16 tetor, 2021, ftoi besimtarët që të

marrin pjesë në procesionin më Figurën e Zojës, nëpër disa rrugë të qytetit për ta ndarë gëzimin e kësaj feste më të gjithë qytetaret e Shkodrës, duke u lutur dhe kënduar këngë të përshpirtshme në nderim të Zojës së Bekuar.

Me 17 tetor, në vigjilje të festës në katedrale u celebrua Mesha e Shenjtë e udhëhequr nga Atë Gazmend Tinaj, dhe meshtarët të tjerë. Pas meshe në oborrin e katedrales u mbajt koncerti me këngë të përshpirtshme nga kori “Miq të e Shën Françeskut”, të udhëhequr nga z. Zef Ndoja, si dhe hedhja e fishekzjarrëve nga kambanorja, tradite kjo e filluar që në vitet sa ishte famullitar i Shkodrës, Mons. Lucjan Augustin.

Dita e kulmore e festës ishte ajo e 18 tetorit, kur Mesha e Shenjte, u kremtua nga Arqipeshkvi i Shkodër-Pult Mons. Angelo Massafra në ora 10, i cili në predikim e tij foli për madhështinë e Zojës së Këshillit të Mirë, dhe rendësin që i ka dhënë kësaj feste historikisht populli i qytetit të Shkodrës. Në fund të meshës, u lëshua dekreti, prot.nr 87/ 2021, dt. 16. X. 2021, se, Kisha katedrale, pos festës së Shën Shtjefnit si pajtor i kryedioqezës, tani e tutje liturgjikisht (zyrtarisht) për kryedioqezën tonë do festohet edhe festa “Zoja e Shkodrës”. Edhe pse emërtimin “Zoja e Këshillit të Mirë”, katedralja në rolin e famullisë e ka përdorur që nga ndërtimi i kësaj Katedrale në vitin 1865, deri në vitin 1995, kur në 1996 e pati ndryshuar emërtimi duke u quajtur, famullia e Shën Shtjefnit. Në orët pasdites, në sallën “Kardinal Koliqi”, u organizua koncerti muzikor nga Ansambli Vokal i Akademisë së Arteve të Tiranës.




Dom Nikë Ukgjini



Dodë Gjergji

DRITONI
Jeta e Imzot Lucjan Avgustin'

Drita, Prishtinë, 2021



ANTON BERISHA

PRUSHI I BUKURISË

Beqir Musliu, Gjilan 2018



FRANCESCO OCCHETTA

JETA PËRTEJ KUFIRIT

Arqipeshkvia Shkodër-Pult
2021

KUMBONA E SË DIELLËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 100 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në eleven studio - www.11stud.io